

QYTETARIA DEMOKRATIKE – PRAKTIKA DHE SHEMBUJ NGA SUEEDIA

Material Informues

Përgatitur në kuadër të projektit
“Forcimi i edukimit për qytetari demokratike në Shqipëri”

QYTETARIA DEMOKRATIKE – PRAKTIKA DHE SHEMBUJ NGA SUECIA

Material Informues

Përgatitur në kuadër të projektit
"Forcimi i edukimit për qytetari demokratike në Shqipëri"

Përgatitur nga NIRAS Sweden AB me mbështetjen e Ambasadës së Suedisë në Shqipëri me kërkesë dhe për t'u përdorur në aktivitete për ngritje kapacitetesh në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës "Forcimi i edukimit për qytetari demokratike në Shqipëri", i financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida)..

Mendimet e shprehura në këtë dokument janë përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Evropës ose Agjencisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida).

PËRMBAJTJA

1.	Hyrje.....	5
1.1	Detyra – qëllimi, fokusi, objekti dhe kufizimet.....	5
1.2	Edukimi i qytetarisë demokratike – koncepti, këndvështrimet dhe prirjet.....	5
2.	Sistemi arsimor suedez	7
2.1	Arsimi – të drejtat dhe detyrimet.....	7
2.2	Struktura dhe fazat.....	7
2.3	Decentralizimi, zgjedhja e shkollave dhe shkollat e pavarura.....	8
2.4	Kuadret kombëtare, fleksibiliteti dhe cilësia.....	9
2.5	Financimi, buxheti dhe pjesëmarrja	10
2.6	Autoritetet shtetërore	11
3.	Edukimi për qytetari demokratike – karakteristikat dhe praktikat kryesore.....	13
3.1	Edukimi demokratik – misioni i rëndësishëm me qasje të gjerë	13
3.2	Edukimi demokratik – përgjegjësi për të gjithë	14
3.3	Kompetencat demokratike në kurrikulën shkollore	15
3.4	Shkollat kanë mision të mbrojnë demokracinë në mënyrë aktive	17
3.5	Pjesëmarrja dhe ndikimi në kontekstin e shkollës	18
3.6	Kërkimi shkencor dhe rezultatet e kërkimit shkencor në edukimin për qytetari demokratike.....	19
4.	Edukimi për qytetari demokratike – shembuj të praktikave, nismave, burimeve dhe bashkëpunimit/eve	21
4.1	Pjesëmarrja dhe ndikimi në nivel shkolle	21
4.1.1	Këshillat e klasave dhe këshillat e nxënësve në praktikë.....	21
4.1.2	Forumi i demokracisë – një hapësirë takimi për temat e vështira në shkollë	22
4.2	Shkëmbimi dhe angazhimi me përfaqësuesit e pushtetit vendor	23
4.2.1	Bashkitë janë aktive për t’u takuar dhe për t’u angazhuar me nxënësit dhe studentët	23
4.2.2	“Çmimi i demokracisë” për propozimet e shkollave sesi të forcohet demokracia	24
4.2.3	Modelet e bashkive për promovimin e njohurive të rinjve mbi demokracinë vendore	25
4.3	Buxheti me pjesëmarrje dhe shkolla si arenë lokale.....	25
4.4	Të mësosh rreth demokracisë në nivel kombëtar përmes aktiviteteve mbështetur në përvojë	27
4.4.1	Zgjedhjet në shkolla	27
4.4.2	Të nxënit përmes përvojës dhe vizitat studimore në Parlamentin suedez	28
4.5	“Çmimet për mësuesin më të mirë” angazhojnë nxënësit dhe studentët	29
4.6	#Tëpremtetpërtëardhmen – greva e shkollës për klimën.....	29

4.7	Të mësosh demokracinë – burime, udhëzues dhe praktika.....	30
4.7.1	“Të flasësh për politikën” dhe “Të flasësh për demokracinë”.....	30
4.7.2	Mësimdhënia dhe mësimnxënia rreth demokracisë duke përdorur filma të shkurtër dhe diskutime.....	29
4.7.3	Kritika e burimeve, bashkëbisedimet demokratike dhe propaganda	31
4.7.4	Përdorimi i “Lajmeve” si pjesë e edukimit qytetar dhe demokratik	32
4.8	Demokracia dhe krimet kundër njerëzimit	32
4.8.1	Materiale pune për demokracinë, tolerancën dhe të drejtat e njeriut	32
4.8.2	Takimi me të mbijetuarit e Holokaustit.....	33
4.8.3	Çmimi i shkollave për Paqen – të mësosh rreth Holokaustit.....	34
4.9	Të nxënit kolektiv, shkëmbimi dhe mësimdhënia ndërdisiplinore	34
4.9.1	Të nxënit kolektiv – shembulli i të punuarit me çështje të debatueshme.....	34
4.9.2	Platforma për shkëmbim dhe frymëzim midis mësuesve.....	34
4.9.3	Mësimi ndërdisiplinor rreth zhvillimit të qëndrueshëm	35
4.10	Shoqëria civile, demokracia dhe rinia.....	36
5.	Burime dhe referenca	39
	Shtojcat	41
	Shtojca 1 – Modeli suedez i administratës qeverisëse	42
	Shtojca 2 – Autoritetet dhe organizatat	43
	Shtojca 3 – Financimi, buxheti, menaxhimi financiar dhe pjesëmarrja	46

1. HYRJE

Ky raport është përgatitur nga NIRAS me mbështetjen e Ambasadës Suedeze në Tiranë në kuadër të një bashkëpunimi në fushën e edukimit për qytetari demokratike. Raporti përmban një hartë të përvojave dhe praktikave përkatëse në Suedi lidhur me edukimin për qytetari demokratike, që mund të shërbejë si frymëzim për kontekstin shqiptar. Hartimi i raportit u krye në periudhën shtator-tetor 2022.

1.1 Detyra – qëllimi, fokusi, objekti dhe kufizimet

Sfondi i kësaj detyre është si vijon: Që prej vitit 2019, Sida/Ambasada e Suedisë në Shqipëri po bashkëpunon me Këshillin e Evropës (KiE) për projektin për përmirësimin e cilësisë së arsimit, “Forcimi i edukimit për qytetari demokratike në Shqipëri”. Projekti e ndërton punën mbi aktivitetet e mëparshme të KiE-së në Shqipëri dhe përqendrohet te mbështetja e politikave, qeverisja demokratike e shkollave (75 shkollave pilote) dhe mbështetja për mësuesit. Ekipi i projektit dhe partnerët (shkollat, drejtoritë arsimore etj.) kanë shprehur interes për përvojat suedeze, që mund të zbatohen në kontekstin e projektit. Ky interes është po ashtu në përputhje me komponentin e projektit për shkëmbim dhe mësimnxënie (përfshi përvojat nga vendet e tjera) dhe konceptin se shembujt praktikë mund të shërbejnë si frymëzim për partnerët dhe palët e interesuara.

Qytetaria demokratike në Suedi nxitet përmes një game të gjerë praktikash dhe aktiviteteve. Ky hartëzim përqendrohet në aktivitetet shkollore dhe jashtëshkollore që ofrohen përmes sistemit arsimor. Sida (Ambasada e Suedisë) dhe Këshilli i Evropës raportojnë se fushat me interes janë: qeverisja demokratike e shkollës, duke përfshirë modelet e buxhetit me pjesëmarrje, mjedisin shkollor ndërkulturor dhe gjithëpërfshirës, partneritetet vendore, nismat e drejtuara nga nxënësit, si dhe praktikat konkrete që synojnë forcimin e edukimit për qytetari demokratike përmes kurrikulës dhe teksteve shkollore, së bashku me të nxënësit praktik për nxënësit dhe angazhimin e prindërve. Gjithashtu i kushtohet vëmendje mësuesit dhe shembujve të burimeve të krijuara për t’i lehtësuar dhe motivuar në praktikat e tyre të mësimdhënies. Sa i takon objektin, hartëzimi përfshin arsimin fillor dhe të mesëm.

Hartëzimi është kryesisht studim dokumentacioni i informacionit dhe raporteve nga autoritetet suedeze dhe entete të tjera përkatëse. Si burim informacioni kanë shërbyer edhe intervistat e shkurtra me informuesit kryesorë. Procesi i hartëzimit është përqendruar te paraqitja e qasjeve dhe praktikave suedeze në raport me edukimin për qytetari demokratike në përgjithësi, por edhe përmes përshkrimesh më të detajuara të praktikave dhe shembujve konkretë. Në hyrje, harta përfshin paraqitjen e karakteristikave kryesore të sistemit arsimor suedez, duke i prezantuar lexuesit kontekstin shkollor suedez.

Për sa u takon kufizimeve, duhet të theksojmë se koha në dispozicion për këtë aktivitet nuk mundësonte një hartëzim të thelluar sistematik të praktikave në nivel shkollor dhe/ose bashkiak. Shembujt e qasjeve dhe praktikave të paraqitura në raport janë përfshirë kryesisht për të ofruar ilustrime dhe për të treguar se ka një larmi praktikash, pa pretenduar se këta janë shembujt më të mirë ose më përfaqësues.

1.2 Edukimi për qytetari demokratike – koncepti, perspektivat dhe prirjet

Edukimi për qytetari demokratike është një koncept i gjerë, që përfshin shumë më tepër sesa njohuritë e fituara nga nxënësit mbi idetë, institucionet dhe procedurat; është një mision edukimi që shkon përtej individit. Edukimi për qytetari demokratike është përshkruar në kuadrin e të rinjve që zhvillojnë një gamë të gjerë kompetencash dhe i fuqizojnë ata të luajnë rol aktiv si qytetarë në shoqëri demokratike e shumëkulture. (Këshilli i Evropës 2010, 2018). Si instrument për nxitjen e edukimit për qytetari demokratike, Këshilli i Evropës ka hartuar *Kuadrin e Referencës së*

Kompetencave për Kulturë Demokratike (KRKCD), i cili përmban 20 kompetenca të ndara në katër grupe: **vlëra, aftësi, dije dhe qëndrime** (Këshilli i Evropës, 2018). Kuadri u hartua për arsimtarët dhe politikëbërësit dhe është miratuar si instrument për nxitjen e edukimit për qytetari demokratike në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës (KE).

Edukimi për qytetari demokratike dhe të drejtat e njeriut vlerësohen si thelbësore për promovimin e kohezionit social, të dialogut ndërkulturor, vlerësimit të larmisë dhe barazisë dhe zgjidhjes pa dhunë të problemeve dhe mosmarrëveshjeve. Për më tepër, është theksuar se një prej objektivave themelore të edukimit për qytetari demokratike nuk është thjesht pajisja e nxënësve me njohuri dhe aftësi, por edhe fuqizimi i tyre për të vepruar në mbrojtje dhe nxitje të të drejtave të njeriut, demokracisë dhe shtetit të së drejtës (Këshilli i Evropës, 2010).

Dy prirjet që mund të favorizojnë zhvillimin në vazhdimësi të edukimit për qytetari demokratike janë:

- 1) Përfshirja e edukimit qytetar dhe të të drejtave të njeriut në agjendën ndërkombëtare, duke theksuar rolin e edukimit për nxitjen e një bote gjithëpërfshirëse, të paqte e demokratike.
- 2) Përqendrim më i madh drejt një qasjeje edukuese të bazuar në kompetenca në mbarë Evropën dhe në nivel ndërkombëtar, duke përfshirë ndryshimin nga ajo çfarë nxënësit mund të mësojnë te mënyra si mund ta aplikojnë atë që mësojnë (Këshilli i Evropës, 2018).

Në të njëjtën kohë, ka një sërë prirjesh negative globale sa i takon zhvillimit demokratik, që mund të shihen si motivuese dhe nxitëse për edukimin për qytetari demokratike. Gjatë periudhës 1989-2012, numri i demokracive liberale në botë u rrit. Megjithatë, kjo ka ndryshuar dhe niveli i demokracisë që gëzon qytetari mesatar global është kthyer tashmë në nivelet e vitit 1989. Ndërkohë, ka pasur një rritje të diktaturave dhe, gjatë 10 viteve të fundit, një përkeqësim domethënës të lirisë së shprehjes dhe respektit për argumentet kundër (V-Dem Institute, 2022). Zonat më pak demokratike në botë gjenden jashtë Evropës, megjithatë, ka prirje negative edhe në vendet evropiane. Kësisoj, nxitja e demokracisë përmes edukimit për qytetari demokratike mund të shihet si një detyrë e rëndësishme në vazhdimësi, për të fuqizuar qytetarët në vendet ku praktikohet demokracia.

Suedia ka një histori relativisht të gjatë të demokracisë. Në vitin 2021, Suedia kremtoi 100-vjetorin e së drejtës së barabartë dhe universale të votës në Parlament (the Riksdag). Në vitin 1921, burrat dhe gratë, nga mosha 23-vjeçare e lart kishin të drejtë të votonin, ndërsa sot, mosha e votimit është 18 vjeç. Reforma e vitit 1921 u krye pas një lufte të gjatë dhe përpjekjesh intensive dhe vendimi konsiderohet si gur themeli në historinë e demokracisë suedeze. Sot, Suedia është një prej 34 demokracive liberale në botë (V-Dem Institute, 2022) e megjithatë, demokracia nuk është e ngurtë që merret si e mirëqenë njëherë e përgjithmonë. Në një kontekst të ndërlidhur global në ndryshim të vazhdueshëm, me kërcënime të reja të mundshme ndaj lirive, të drejtave dhe praktikave demokratike, qeveria suedeze nxit vazhdimisht demokracinë përmes një game të gjerë nismash dhe mekanizmash mbështetëse. Në vitin 2018, qeveria paraqiti një strategji të re të përqendruar te promovimi, forcimi dhe mbrojtja e demokracisë dhe, në kuadër të festimit të 100-vjetorit, investoi në mënyrë të veçantë në mbështetje të demokracisë, përmes projekteve dhe mekanizmave të ndryshme, që angazhuan shumë agjenci publike, organizata të shoqërisë civile dhe institucione arsimore.

2. SISTEMI ARSIMOR SUEDEZ

Arsimi është një e drejtë dhe detyrim ligjor për fëmijët në Suedi. Ka një sërë autoritetesh dhe entesh qeveritare që kanë për detyrë të nxitin cilësinë e lartë të arsimit në mënyra të ndryshme, përmes ofrimit të orientimit dhe burimeve, mbikëqyrjes dhe kontrollit si edhe qasjen, në rezultatet kërkimore me rëndësi për mësuesit dhe organizatorët e shkollave. Ky kapitull paraqet një panoramë të shkurtër të sistemit arsimor suedez, që përqendrohet te të drejtat dhe rregullat, si është i strukturuar sistemi shkollor në faza, si dhe një hyrje të përgjithshme sesi organizohet dhe financohet arsimi, përfshirë ndarjen e përgjegjësisë për drejtimin e shkollave, duke siguruar arsim cilësor. Fokusi kryesor i kësaj panorame të përgjithshme është tek arsimi fillor dhe i mesëm, pasi është rënë dakord që hartëzimi të përqendrohet pikërisht në këto cikle arsimore.

2.1 Arsimi – të drejtat dhe detyrimet

Suedia ka një histori të gjatë të arsimit publik. Në vitin 1842, Parlamenti suedez prezantoi për herë të parë sistemin e arsimit fillor katërvjeçar, që, më pas, u plotësua me klasa më të larta. Arsimi u bë i detyrueshëm për shtatë vjet në vitet '30, për tetë vjet në vitet '50 dhe për 9 vjet në vitet '70. Sot, sistemi arsimor suedez përfshin arsimin e detyrueshëm dhe jo të detyrueshëm. **Fëmijët suedezë ndjekin shkollën për të paktën 10 vjet (e detyrueshme) dhe kanë të drejtën të ndjekin arsimin e mesëm falas (jo i detyrueshëm).** Arsimimi për të rritur dhe arsimi i lartë në universitete dhe kolegje ofrohet gjithashtu falas për qytetarët dhe personat me qëndrim në Suedi.

E drejta për arsimim falas është e përcaktuar me ligj (*Ligji suedez për arsimin 2010:800*). Ligji po ashtu parashikon të drejtën për qasje të barabartë në arsim dhe arsim të barabartë për të gjithë fëmijët, pavarësisht nga prejardhja gjeografike dhe kushtet shoqërore ose ekonomike. E drejta për arsimim shprehet, gjithashtu, si detyrim ligjor sepse të gjithë fëmijët duhet të ndjekin arsimin e detyrueshëm, që kur mbushin gjashtë vjeç.

Sistemi arsimor kombëtar bazohet në një themel demokratik dhe synimi i arsimit është formuluar si përftimi dhe zhvillimi i dijeve dhe vlerave nga nxënësit. Nxënësit dhe studentët kanë të drejtën të mos jenë objekt i keqtrajtimit, fyerjeve, diskriminimit, racizmit dhe ngacmimit. Mësimdhënia në shkollë është laike. Nxënësit dhe studentët, që nuk e kanë suedishten gjuhën e tyre amtare, gëzojnë të drejtën të përfitojnë trajnime më vete për gjuhën, me qëllim për t'iu mundësuar zhvillimin e njohurive mbi gjuhën e tyre amtare, ashtu si edhe mbi suedishten.

Të drejtat e fëmijëve përcaktohen në *Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (Konventa e Fëmijës)*. Një mesazh kyç i konventës lidhet me vlerësimin dhe marrjen përherë në konsideratë të interesit të fëmijës, kur merren vendime që ndikojnë tek ata. Kjo vlen edhe për shkollat suedeze. Suedia e ratifikoi *Konventën e Fëmijës* në vitin 1990, por e kishte nisur shumë kohë më parë punën për nxitjen e të drejtave të tyre. Në vitin 1950, për shembull, Suedia e shpalli të paligjshëm ndëshkimin fizik që ushtronin mësuesit. Parimet e **Konventës së Fëmijës** kanë udhëhequr arsimin suedez dhe, që prej vitit 2020, ato janë përfshirë në legjislacionin suedez.

2.2 Struktura dhe fazat

Sistemi shkollor në Suedi përqafon arsimimin e detyrueshëm (arsimi fillor) dhe arsimin jo të detyrueshëm (arsimi i mesëm). Përveç kësaj, sistemi arsimor, përfshin kopshtet si një aktivitet arsimor në grup (jo i detyrueshëm) për fëmijët nga mosha një vjeç dhe arsimimin për të rritur.

Arsimi fillor ('*Grundskolan*,' i detyrueshëm) ndahet në katër faza:

Klasa parashkollore, një vit (mosha 6 vjeçe) '*Förskoleklass*'

Klasa 1-3 (mosha 7-9 vjeçe) 'Lågstadiet'

Klasa 4-6 (mosha 10-12 vjeçe) 'Mellanstadiet'

Klasa 7-9 (mosha 13-15 vjeçe) 'Högstadiet'.

Fëmijëve të grupmoshës 6-13 vjeçe u ofrohet edhe kujdes jashtëshkollor, përpara dhe pas orarit mësimor, për t'u përshtatur me orarin e punës së prindërve. Arsimi fillor i detyrueshëm përfshin po ashtu shkollat *Sami* për fëmijët e popullatës indigjene *Sami*. Fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore (NVA), zakonisht, frekuentojnë shkollat e detyrueshme normale dhe ndjekin, për aq sa është e mundur, kurrikulën kombëtare, duke i kushtuar vëmendje të veçantë përmbushjes së nevojave individuale të të nxënësve, sipas planit individual të veprimtimit. Vetëm në disa rrethana, fëmijët me nevoja të veçanta arsimore ndjekin programe të posaçme.

Arsimi i mesëm ('*Gymnasiet*', jo i detyrueshëm) përmendet si fakultativ e falas dhe përfshin persona të grupmoshës 16-20 vjeçe. Ka rreth 18 programe kombëtare të rregullta me kohëzgjatje 3-vjeçare mes të cilave mund të zgjedhësh, si dhe programe përgatitore për arsimin e lartë dhe programe të orientuara drejt arsimit profesional. Kushtet e pranimit janë nota kaluese në gjuhën suedeze, atë angleze dhe matematikë. Në vitin 2021, rreth 87 për qind e nxënësve që përfundonin arsimin fillor (pas klasës së 9-të) u kualifikuan në arsimin e mesëm.

Në raport, "nxënës" do të përdoret kur u referohemi fëmijëve në arsimin fillor (nga cikli parashkollor deri në klasë të 9) dhe "studentë" për të rinjtë në arsimin e mesëm (tre vjet).

2.3 Decentralizimi, zgjedhja e shkollës dhe shkollat e pavarura

Në krahasim me shumë vende, sistemi arsimor suedez është relativisht i decentralizuar. Shkollat suedeze kontrolloheshin drejtpërdrejt nga qeveria qendrore deri më 1991, vit kur sistemi i administrimit të shkollave nga qeveria ndryshoi përmes një procesi decentralizimi, duke e kaluar administrimin në nivel bashkiak. Reforma synonte t'u jepte më shumë zë dhe përgjegjësi autoriteteve vendore në administrimin e shkollave. Për një panoramë të shkurtër të modelit të administrimit qeveritar, shih shtojcën.

Siç parashikohet në Ligjin për Arsimin (2010:800), të **290-të bashkitë e Suedisë janë përgjegjëse për ofrimin e arsimit** në shkollat e sektorit publik. Kështu, bashkitë kanë përgjegjësi kryesore për organizimin dhe ofrimin e arsimit në nivelin parashkollor, të arsimit fillor dhe atij të mesëm. Ligji suedez për pushtetin vendor përcakton se çdo bashki qeveriset nga një organ i zgjedhur, që është Asambleja Bashkiake. Asambleja është përgjegjëse për caktimin e komisionit arsimor për qeverisjen e sistemit të arsimit publik dhe për të garantuar ofrimin e arsimit në përputhje me rregullat kombëtare. Pas decentralizimit, në fillim të viteve '90, bashkitë janë përgjegjëse për shpërndarjen e burimeve dhe mbajnë përgjegjësinë e punëdhënësit për mësuesit.

Bashkitë nuk janë ofruesit e vetëm shkollorë në sistemin arsimor. Ka po ashtu **një gamë relativisht të gjerë shkollash të pavarura që funksionojnë me financim publik**. Ky zhvillim lidhet me reformat e fillimit të viteve '90, që i hapën rrugë së ashtuquajturës '*zgjedhje e lirë e shkollës*' dhe çeljes së shkollave të pavarura. Shkurtimisht, sipas këtyre ndryshimeve prindërit dhe fëmijët e tyre lejoheshin të zgjidhnin midis shkollave pa pagesë, qofshin ato të bashkisë apo private, ndërkohë që organizatorët e pavarur mund të hapnin dhe të drejtonin shkollat, pas marrjes së lejes dhe të përfitonin financim publik të përlogaritur mbi numrin e studentëve. Shumica e shkollave janë publike, por numri i shkollave të pavarura është rritur, kryesisht në zonat metropolitane. Gjatë viteve 2020-2021, rreth 17 % e shkollave fillore dhe 35 % e shkollave të mesme ishin shkollat e pavarura. Ato tërheqin 16% të të gjithë fëmijëve në moshë të detyruar shkollorë dhe 29 % të të gjithë studentëve të arsimit të mesëm të lartë. Sërisht, nga më shumë se 1 milion nxënës në arsimin e detyrueshëm, thuhet se 85 % e të gjithë fëmijëve ndjekin shkollat publike (*Instituti suedez, 2021*).

Bashkitë dhe ofruesit e shkollave të pavarura janë të organizuar në dy shoqata: *Shoqata Suedeze e Autoriteteve Vendore dhe Rajoneve dhe Shoqata Suedeze e Shkollave të Pavarura*, që përfaqësojnë organizuesit e shkollave private (shih Shtojcën 2). Këto shoqata janë të angazhuara për zbatimin e aktiviteteve arsimore, organizimin dhe funksionimin e shërbimeve shkollë, ofrimin e burimeve dhe garantimin e përmbushjes së objektivave kombëtare arsimore.

2.4 Kuadret kombëtare, fleksibiliteti dhe cilësia

Arsimi suedez rregullohet nga ligjet, vendimet, kurrikulat, planet mësimore dhe sistemi i notave etj. Të njëjtat **dokumente rregullatore kombëtare** zbatohen për të gjitha shkollat, pavarësisht nëse janë publike apo funksionojnë si të pavarura. Ligji suedez i Arsimit (2010:800) dhe Vendimi për Arsimin (2011:185) parashikojnë rregulla për të gjitha nivelet, nga arsimi parashkollor deri tek arsimi i mesëm i lartë. Vendimet për arsimin miratohen nga qeveria. Një shembull, përveç Vendimit për Arsimin, është Vendimi për Pjesëmarrjen e Fëmijës dhe Nxënësit në punën për Hartimin e një Plani për Trajtimin e Barabartë. Të gjitha kurrikulat janë edhe vendime dhe rregullojnë objektivat themelore, udhëzimet dhe planet mësimore. Ka kurrikula kombëtare për çdo cikël të veçantë shkollimi; për kopshtin, vitin parashkollor (mosha 6 vjeç), shkollën fillore, shkollën e mesme, shkollën Sami, si dhe për arsimin për nxënësit dhe studentët me nevojë të veçanta dhe të rriturit. Testet e detyrueshme kombëtare hartohen dhe organizohen në nivel kombëtar. Sistemi i vlerësimit përfshin një gamë prej gjashtë notash, nga A në F, ku A deri në E janë nota kaluese dhe F përfaqëson notën mbetëse. Në Suedi, që nga viti 2012, nxënësve dhe studentëve u vendosen nota nga klasa e gjashtë e shkollës fillore.

Mësuesit suedezë përdorin një **gamë të gjerë materialesh mësimore**. Digjitalizimi ka sjellë shtimin e burimeve dhe materialeve didaktike, që janë të vlefshme në formë digjitale, përdorimin e gjerë të instrumenteve digjitale në shkollë, duke përfshirë përdorimin e një kompjuteri personal për shumë studentë që ndjekin arsimin e mesëm, që, njëherësh, është gjë e zakonshme edhe për arsimin fillor. Ka disa organizata, qoftë shoqëri tregtare dhe fondacione, që prodhojnë materiale mësimore në formën e librave dhe burimeve digjitale. Një sërë autoritetesh qeveritare, gjithashtu, prodhojnë materiale mësimore që mund të konsultohen falas në internet. Nuk ka rregulla specifike se cili material mësimor duhet përdorur në shkollë, por mësuesit dhe ekipet e mësuesve kanë rol kyç dhe **fleksibilitetin për të vendosur se cilat materiale mësimore do të përdorin**. Për ta është më e përshtatshme të përzgjedhin materialet mësimore që janë të dobishme në kontekstin në të cilin po punojnë, duke qenë se kanë njohuri lëndore dhe didaktike, si dhe kuptojnë njohuritë dhe nevojat bazë të nxënësve dhe studentëve të tyre. Drejtuesit dhe organizuesit e shkollave (bashkitë dhe shkollat e pavarura) mund të përfshihen gjithashtu në procesin e vendosjes dhe të porositjes së materialeve mësimore, pasi kanë përgjegjësi për buxhetin e përgjithshëm, ku bën pjesë blerja e tyre. Drejtuesit, gjithashtu, luajnë rol për nxitjen e kushteve favorizuese për planifikimin afatgjatë të blerjeve të materialeve mësimore.

Organizatorët e shkollave janë **përgjegjës për të garantuar cilësinë në arsim** në përputhje me të gjitha rregullat dhe kërkesat. Organizatorët e shkollës kanë detyrimin ligjor të punojnë sistematikisht për cilësinë në arsim, të planifikojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe ta ndjekin në vijimësi arsimin, të analizojnë shkaqet e rezultateve dhe t'i përdorin këto rezultate në punën e vazhdueshme zhvillimore. Mënyra se si realizohet kjo në praktikë, varet nga fakti nëse organizatori është bashki e madhe apo e vogël, nëse kemi të bëjmë me organizator të madh apo të vogël të shkollës së pavarur. Për sa i takon nxitjes së cilësisë, ka po ashtu një sërë autoritetesh shtetërore që kanë mision të garantojnë cilësinë e mirë në shkollë, si përmes ofrimit të mbështetjes për drejtuesit dhe mësuesit me orientim pedagogjik, materialeve mësimore për tema të ndryshme, ashtu edhe përmes kontrollit dhe mbikëqyrjes së shkollave.

2.5 Financimi, buxhetimi dhe pjesëmarrja

Autoritetet vendore kanë detyrimin ligjor të ofrojnë një sërë shërbimesh bazë mes të cilave arsimit fillor, arsimit mesëm dhe kujdesi për fëmijën (përmes kopshteve) përbëjnë një pjesë thelbësore. Një pjesë e madhe e financimeve vijnë nga **të ardhurat prej taksave bashkiake**, që shpërndahen më tej sipas modeleve të ndryshme të financimit, në varësi të bashkisë. Një nga objektivat e delegimit të sistemit shkollor të bashkitë ishte se shpërndarja e burimeve duhej të ishte më e përshtatshme dhe në përputhje me nevojat dhe përparësitë vendore. Bashkitë janë të lira të përdorin taksat e mbledhura dhe fondet shtetërore për çfarëdo shërbimi apo sistemi, megjithatë, financimi i shkollave nuk është tërësisht në varësi të bashkisë, sepse shpërndarja e përgjithshme e fondeve ndikohet edhe nga e ashtuquajtura 'zgjedhje e lirë e shkollës' pas vendimit të miratuar në parlament për futjen e **një sistemi të pagesave të transfertave kompensuese (kuponët shkollorë) që lidhen me nxënësit/studentët** dhe jo me shkollën. Transferta është përlogaritur të mbulojë jo vetëm arsimimin, por edhe shpenzimet e tjera, si vaktet ushqimore dhe shërbimet shëndetësore. Sipas këtij sistemi, secilit nxënës i jepet një sasi parash, që e mbështet atë në çdo shkollë që zgjedh, qoftë bashkiake, qoftë e pavarur. Si shkollat bashkiake, ashtu edhe ato të pavarura financohen përmes sistemit të kuponëve shkollorë. Shkolla që merr financime në këtë mënyrë nga bashkia, nuk ka të drejtë të mbledhë tarifa shkollore, por është e lirë të vetorganizohet e të vetëfunksionojë (për shembull: sistemi i drekës në shkolla, pagat e mësuesve, mësuesit ndihmës etj.) dhe lejohet të marrin fitime, d.m.th., nuk janë të detyruar ta investojnë fitimin në shkollë. Kjo praktikë është debatuar në parlamentin suedez.

Procesi i vendimmarrjes në nivel bashkiak përfshin hapat në vijim:

1. *Asambleja* e zgjedhur në nivel vendor merr vendime lidhur me buxhetin bashkiak, që përfshin buxhetin për sistemin arsimor në bashki. Buxheti për arsimin mbështetet në numrin e fëmijëve në moshë shkollore të regjistruar në bashki.
2. *Bordi ekzekutiv* përgjegjës për arsimin përlogarit sasinë e kuponëve shkollorë të bashkisë duke u mbështetur në dispozitat e *Ligjit për Arsimin*, ndërkohë që fondet e përgjithshme për çdo shkollë shpërndahen në bazë të numrit të studentëve. Disa bashki lejojnë edhe shpërndarjen e burimeve shtesë për shkollat me rezultate të ulëta dhe/ose me nxënës të paprivilegjuar nga pikëpamja sociale.

Në Suedi, **buxhetimi me pjesëmarrje** nuk rregullohet me ligj dhe, nga ana tjetër, nuk ka një traditë të fortë në angazhimin e qytetarëve në proceset e buxheteve rajonale ose vendore, në përputhje me metodologjinë e buxhetimit me pjesëmarrje. Ndërkohë, *Shoqata Suedeze e Autoriteteve Vendore dhe Rajoneve (ShSAVR)* është angazhuar për nxitjen e procedurave të buxhetimit me pjesëmarrje prej disa vitesh dhe ka hartuar një model, si dhe ka ngritur një rrjet bashkish për të zhvilluar më tej praktikën e buxhetimit me pjesëmarrje. Sipas, ShSAVR-së, gjatë viteve të fundit, janë zbatuar rreth 25-30 projekte në fusha të ndryshme të përgjegjësisë bashkiake. Disa prej këtyre shembujve përfshijnë bashkitë që përqendrohen në angazhimin e nxënësve dhe studentëve në procesin e dhënies së ideve, të përcaktimit të përparësive, si dhe votimit lidhur me investimet bashkiake në terrenet e lojërave, zonat argëtuese, aktiviteteve passhkollore etj. (Për më shumë hollësi, shih rubrikën 4.3)

Në nivel shkolle, **fëmijët suedezë kanë mundësi për të ndikuar në aktivitetet e shkollës, ku përfshihen edhe investimet**. Shumë shpesh, ky ndikim lidhet me investime të vogla në pajisjet sportive dhe këndet e lojërave, që mund të përdoren gjatë pushimeve shkollore ose investime për aktivitete shkollore, që zhvillohen me propozimin e fëmijëve. Megjithatë, ndonjëherë, fëmijët mund të konsultohen edhe në lidhje me investime më të mëdha, si për shembull, këndet e lojërave. Ky lloj ndikimi shpesh organizohet përmes një procesi konsultimesh, që kryhet në kuadër të këshillave të klasës dhe të shkollës, si dhe të shoqatave studentore (shih Kapitullin 3 dhe 4).

2.6 Autoritetet qeverisëse

Qeveria qendrore në Suedi ka përgjegjësinë e përgjithshme për arsimin dhe është e ngarkuar me hartimin e politikave dhe objektivave kombëtare, me hartimin e kurrikulës, të udhëzimeve, si dhe me kontrollin e cilësisë, kërkimin shkencor etj. Në nivel qendror, përgjegjësitë ndahen midis *Ministrit të Arsimit dhe të Kërkimit Shkencor* dhe autoriteteve kombëtare autonome të ngritura me ligj. Përveç kësaj, ka një sërë organizatash anëtare joqeveritare që përqendrohen tek arsimi. Më poshtë, paraqesim shkurtimisht autoritetet kryesore qeveritare me mandate specifike që lidhen me edukimin për qytetari demokratike. Hollësi të mëtejshme për to dhe për autoritete e organizata të tjera të përqendruara tek arsimi, duke përfshirë edhe adresat e burimeve, gjenden në Shtojcën 2.

- **Ministria e Arsimit dhe e Kërkimit Shkencor** është përgjegjëse për politikën arsimore dhe kërkimore shkencore të qeverisë. Gjithashtu, ministria punon për çështje që përfshijnë ecurinë e shkollës, kushtet e mësuesve dhe financimin e studimeve.
- **Agjencia Kombëtare Suedeze e Arsimit** (*Skolverket*) është autoriteti administrativ qendror për arsimin, përgjegjëse për të garantuar që të gjithë fëmijët të kenë qasje në të njëjtin standard arsimor të cilësisë së lartë. Agjencia përgatit rregullore dhe rekomandime, ku bëjnë pjesë kurrikulat, planet mësimore dhe kriteret e vlerësimit me nota. Përveç kësaj, agjencia mbështet punën zhvillimore, siguron materiale mbështetëse dhe është përgjegjëse për certifikimin kombëtar të mësuesve, grantet specifike qeveritare dhe, statistikën zyrtare të arsimit.
- **Inspektorati Suedez i Shkollave** (*Skolinspektionen*) është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe sigurimin e cilësisë së shkollave në mbarë vendin përmes inspektimeve të rregullta, si dhe për vlerësimin e aplikimeve për hapjen e shkollave të pavarura. Inspektorati monitoron përputhshmërinë me legjislacionin (Ligjin për Arsimin) dhe rregulloret. Synimi kryesor është të kontribuojë për përmirësimin dhe zhvillimin e shkollës. Inspektorati Suedez i Shkollave përfshin gjithashtu **Përfaqësuesin e Fëmijës dhe Studentëve të Shkollave** (*Barn-och elevombudet/BEO*), që mbron të drejtat e fëmijëve në kopsht, të nxënësve dhe studentëve në shkollë dhe shqyrton raportimet për bullizëm dhe sjellje abuzive në shkollë. Kjo strukturë gëzon të drejtën të pretendojë dëmshpërblime për llogari të fëmijëve dhe studentëve të shkollave që kanë qenë objekt i sjelljes abuzive dhe bullizmit.
- **Instituti Kërkimor Suedez i Arsimit** (*Skolforskningsinstitutet*) është agjenci qeveritare përgjegjëse për të kontribuar në zhvillimin dhe mësimnxënien, përmes publikimit të studimeve kërkimore, si dhe financimit të kërkimit, që bazohet në praktikën e mësimdhënies dhe mësimnxënies në nivelin parashkollor dhe shkollor.
- **Agjencia suedeze e Rinisë dhe Shoqërisë Civile** (*Myndigheten för ungdoms-och civilsamhällesfrågor*) ka për detyrë të përhapë njohuri për kushtet e jetesës së të rinjve dhe kushtet për shoqërinë civile. Agjencia është përgjegjëse për të garantuar përfshirjen e mendimit dhe të këndvështrimit të të rinjve nga agjencitë shtetërore, për t'iu ofruar mbështetje bashkive në politikën e tyre rinore dhe për t'u shpërndarë grante organizatave të vogla dhe të mëdha. Gjatë viteve zgjedhore, agjencia ngarkohet nga qeveria me detyrën për të mbështetur organizimin e zgjedhjeve në shkollë. Ajo ka hartuar material mjaft të vlefshëm metodologjik për ligjërimin demokratik në shkollë. Po ashtu, agjencia është angazhuar për zhvillimin e modeleve, nga ana e bashkisë, që mund të nxitin njohuritë e të rinjve rreth demokracisë vendore.

3. EDUKIMI PËR QYTETARI DEMOKRATIKE – TIPARET DHE PRAKTIKAT KRYESORE

Shkollat në Suedi kanë të shprehur qartë detyrën për nxitjen e demokracisë përmes edukimit për qytetari demokratike. **Sistemi arsimor ka “një mision demokracie” ose “një detyrë demokracie”** dhe ky mision duhet të përshkojë të gjitha funksionet dhe veprimtaritë në shkollat suedeze. Nxënësit dhe studentët duhet të përftojnë njohuri rreth demokracisë, por edhe njohuri, vlera dhe aftësi përmes demokracisë dhe për demokracinë. Kjo nënkupton se **misioni i demokracisë së sistemit arsimor suedez është i gjerë dhe nuk kufizohet te mësimi i lëndëve të veçanta ose te të mësuarit me një mësues**. Misioni është përgjegjësi e përbashkët e të gjithë personelit të shkollës dhe një thirrje për të përfshirë gjerësisht vlerat dhe parimet demokratike, për të treguar vlerat e demokracisë në praktikë dhe njëherësh për të angazhuar nxënësit dhe studentët për zbatimin në praktikë të këtyre vlerave e parimeve. Të gjitha shkollat kanë mekanizma për pjesëmarrjen dhe ndikimin e nxënësve/studentëve dhe janë të detyruara të punojnë në mënyrë aktive për të nxitur vlerat demokratike në punën e tyre të përditshme, si dhe për të trajtuar e për t’iu kundërvënë modeleve tradicionale gjinore dhe të gjitha formave të diskriminimit, racizmit, bullizmit apo ngacmimeve që mund të ndodhin në shkolla apo mund të ndikojnë në aktivitetet shkollore.

3.1 Edukimi demokratik – mision i rëndësishëm me qasje të gjerë

Ashtu siç përshkruhet në kapitullin 2, Suedia ka një histori relativisht të gjatë të edukimit publik. Tradicionalisht, sistemi arsimor ka pasur rolin kyç në formimin e qytetarëve besnikë. Misioni demokratik i sistemit arsimor suedez nisi paralelisht me procesin e përgjithshëm të demokratizimit. Ideja e krijimit të shoqërive paqësore, përmes sistemit arsimor, nisi të ndikojë në reformat shkollore pas Luftës së Parë Botërore, duke i vënë theksin rolit të njohurive të marra nga fëmijët në shkolla, të cilat i përgatisin ata të përfshihen në jetën e punës dhe në shoqëri në përgjithësi. Megjithatë, misioni i formimit të qytetarëve demokratikë, përmes sistemit arsimor mbështetur në vlera e parime demokratike, u theksua më shumë vetëm pas Luftës së Dytë Botërore. **Roli i rëndësishëm i shkollave për nxitjen e shoqërisë demokratike** është theksuar vazhdimisht që prej vitit 1948, kur misioni demokratik u theksua së pari në një raport zyrtar nga Komisioni i Shkollës. Komisioni paraqiti një vizion të një shoqërie të demokratizuar përmes arsimit dhe hodhi themelet për barazinë në arsim, përfshirje dhe masa kompensuese për nxënësit e paprivilegjuar. Ky ishte një hap i rëndësishëm, larg sistemit të diferencuar, të cilit i erdhi fundi me reformën gjithëpërfshirëse shkollore në vitin 1950. Kështu, efektet e para të ambicieve demokratike ishin të sigurohej një qasje e gjerë në arsim përmes reformave të ndryshme dhe, më pas, të garantohej e drejta për arsimim të barabartë (për të mos veçuar asnjë nxënës e student) dhe për marrjen e dijeve të përbashkëta dhe të barabarta. Në vitin 1980, u prezantua një kurrikul e re për arsimin e detyruar, në të cilën shprehej qartë se shkollat kanë përgjegjësi për nxitjen e respektit për vlerat themelore demokratike. Kjo ishte pikënisja për një qasje më të gjerë dhe më të integruar në lidhje me garantimin e zhvillimit të kompetencave demokratike.

Përpara shqyrtimit më të hollësishëm të Edukimit për Qytetari Demokratike, është me dobi të shohim edhe një degë të edukimit për demokraci që është zhvilluar paralelisht dhe më vonë, si pjesë e reformave arsimore, e cila është **pjesëmarrja dhe ndikimi nga ana e nxënësve dhe studentëve**. Që në vitet '40, studentët e shkollave të mesme suedeze u vetorganizuan në mënyrë për të ndikuar në vendimmarrje që lidheshin me to. Në vitet '60 dhe '70, kjo u zyrtarizua në këshillat e nxënësve/studentëve, ku nxënësit dhe studentët mund të merrnin pjesë dhe të ushtronin ndikim mbi veprimtaritë e shkollës, si: rregullat, vaktet e të ngrënit, detyrat e shtëpisë. Ideja ishte të nixtej kënaqësia e

përgjithshme dhe angazhimi në shkollë, por edhe një mënyrë për nxitjen e interesit për të marrë pjesë në shoqërinë civile. Më vonë, u përdor si mjet për krijimin e kompetencave demokratike përmes modeleve të të nxënësve përmes përvijës. Ditët e sotme, këshillat e nxënësve dhe studentëve janë të përcaktuara në ligjin e sistemit arsimor suedez.

Sot, edukimi demokratik zhvillohet si një mision i gjerë dhe kompleks, që përfshin si detyrën kryesore të nxitjes së kompetencave demokratike, ashtu edhe garantimin e arsimit të barasvlershëm dhe luftën kundër sjelljes abuzive. Shkurtimisht, edukimi suedez për qytetari demokratike mund të përshkruhet si trepalësh, sa i takon angazhimit të nxënësve dhe studentëve **1) për të mësuar rreth demokracisë, 2) përmes praktikave demokratike dhe 3) për demokracinë**. Misioni merr parasysh gjithashtu se sistemi arsimor ka përgjegjësinë të garantojë një mjedis të nxënësi që karakterizohet nga parimet dhe vlerat demokratike, si dhe që njeh dhe respekton të drejtat e fëmijës. Funksionet dhe veprimtaritë shkollore duhet të përshkohen nga praktikat demokratike bazë dhe nga respektimi i të drejtave të njeriut, gjë që nënkupton se mbledhjet midis studentëve, kolegëve dhe prindërve duhet të mbështeten në vlera demokratike.

Rregullat suedeze përcaktojnë se shkollat duhet të formojnë aftësi për ushtrimin e qytetarisë aktive, duke përfshirë vlerat themelore demokratike, njohuritë e nevojshme teorike për të marrë pjesë aktive në shoqëri dhe një gamë të gjerë aftësish dhe kualifikimesh praktike, për të jetuar dhe punuar në një shoqëri demokratike, si: shkrimi dhe leximi, aftësi matematikore bazë, aftësi komunikimi, aftësia për nxjerrjen e informacionit, si dhe të menduarit kritik. Dija, vlerat dhe aftësitë duhen integruar në të gjithë mësimdhënien përmes dialogut, reflektimit kritik dhe analizës – duke nxitur kompetencat demokratike përmes formimit të mbështetur në praktikë për të gjitha lëndët. **Mësimi i vlerave demokratike nuk është thjesht çështje e shpjegimit se cilat janë vlerat demokratike, por ato duhen demonstruar edhe në praktikë.** Detyra e përcjelljes së vlerave demokratike nuk ndahet nga puna e përditshme shkollore, ajo është pjesë e pandashme e saj.

Demokracia dhe vlerat janë pjesë e procesit sistematik të sigurimit të cilësisë, që duhet ndërmarrë nga të gjithë organizatorët e shkollave. Sipas Agjencisë Kombëtare të Arsimit, praktika e zbatimit të një qasjeje të përbashkët e të njëtrajtshme u jep mundësi shkollave ta shohin më të gjerë panoramën e zhvillimit të njohurive të studentëve, të bëjnë punë nxitëse dhe parandaluese me vlerat bazë dhe **të përmbushin detyrën e formimit të qytetarëve** me vlera demokratike. Shkolla nuk është thjesht vend ose institucion publik; drejtuesi i saj është përgjegjës për një mjedis pune të sigurt shkollore. Gjatë vitit 2022-23, Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Forumi 'Historia Jeton' u angazhuan për fuqizimin e mëtejshëm të shkollave, për të zbatuar një qasje sistematike ndaj edukimit demokratik. Vëmendja është përqendruar te zhvillimi i burimeve për hartëzimin dhe monitorimin e edukimit demokratik (funksionet, vlerat, mësimdhënia, njohuritë etj.); tek ofrimi i burimeve lehtësisht të përdorshme, si edhe te mbështetja e procesit për shkolla individuale.

3.2 Edukimi demokratik – një përgjegjësi për të gjithë

Siç shpjegohet në kapitullin 2, *Ligji Suedez i Arsimit*, kurrikula, planet mësimore dhe sistemi i notave, si dhe udhëzuesi i *Agjencisë së Arsimit* përbëjnë kuadrin rregullator të sistemit arsimor. Respektimi dhe nxitja e vlerave demokratike është një temë e përsëritur në të gjitha rregulloret e sistemit arsimor suedez, paralelisht me misionin që nxënësit dhe studentët të përftojnë kompetenca demokratike. Të gjitha rregulloret kombëtare përfshijnë dispozita në lidhje me misionin demokratik të sistemit arsimor, duke përfshirë këtu referimin ndaj *Ligjit Suedez kundër Diskriminimit*. Ligji për Arsimin shpreh qartë misionin që nxënësit/studentët të përftojnë dhe të zhvillojnë njohuri dhe vlera dhe, gjithashtu, që të përcjellë e të thellojë respektin për të drejtat e njeriut dhe vlerat themelore demokratike.

I gjithë personeli që punon në shkollë ka përgjegjësi për misionin e demokracisë. Ligji për arsimin përcakton se jo vetëm mësuesit, por i gjithë personeli i shkollës duhet të punojë për nxitjen dhe respektimin e vlerave thelbësore të çdo individi dhe të mjedisit shkollore, ndërkohë që shkolla duhet të përfaqësojë dhe të përcjellë respektimin e qenies njerëzore, të lirive dhe integritetit individual, të trajtimit të barabartë të të gjithë njerëzve pa dallime gjinore dhe solidaritetin midis njerëzve. Përgjegjësia e përbashkët theksohet në mënyrë të veçantë në kurrikula. Në pjesët hyrëse të kurrikulës për klasën parashkollore (mosha 6 vjeçe), për shkollën fillore dhe atë të mesme, synohet përfshirja

e të gjithë aktorëve shkollorë, duke iu referuar themeleve demokratike të sistemit arsimor suedez, si dhe objektivit se arsimi duhet të respektojë të drejtat e njeriut dhe vlerat themelore demokratike mbi të cilat mbështetet shoqëria suedeze, duke i përcjellë ato te nxënësit.

Lidhur me normat dhe vlerat, kurrikula për **shkollat e mesme** qartëson, se të gjithë ata që punojnë në këtë cikël duhet të kontribuojnë për të zhvilluar ndjenjën e përkatësisë te studentët, solidaritetin me shokët dhe me grupet e paprivileguara dhe përgjegjësinë ndaj njerëzve jashtë rrethit të afërt. Përgjegjësi të tjera, që shtrihen jo vetëm te personeli pedagogjik, por te gjithë personeli, janë: nxitja në mënyrë aktive e barazisë, respektimi dhe marrja e masave të nevojshme për të luftuar dhe parandaluar të gjitha format e diskriminimit, ngacmimit dhe trajtimit degradues dhe për të treguar respekt për studentin, individin, si dhe zbatimi i një qasjeje demokratike. Ka edhe **përgjegjësi shtesë për mësuesit**, si: shpjegimi i vlerave themelore demokratike të shoqërisë suedeze dhe i të drejtave të njeriut dhe diskutimi, së bashku me studentët, i konflikteve që mund të ndodhin në ngjarje aktuale midis këtyre vlerave e të drejtave. Përveç kësaj, mësuesit duhet të diskutojnë hapur dhe bashkë me studentët të analizojnë vlerat, pikëpamjet dhe problemet e ndryshme, si dhe pasojat e tyre. Një tjetër përgjegjësi e mësuesve është të shpjegojnë normat dhe rregullat e shkollës që shërbejnë si themele për punën e tyre. Po kështu, mësuesit duhet të diskutojnë dhe hartojnë rregulla për të punuar në grupe bashkë me studentët.

3.3 Kompetencat demokratike në kurrikulën shkollore

Qysh në pjesët hyrëse të kurrikulës përshkruhen një sërë kompetencash demokratike që duhet të përmbushen nga mësuesit e personeli i shkollës. **Gjithashtu, kurrikula rregullon se cilat kompetenca demokratike duhet të mësojnë dhe të zhvillojnë të gjithë nxënësit dhe studentët individualë.** Në klasën parashkollore dhe në shkollën fillore, nxënësit duhet të zhvillojnë kompetenca, si: aftësia e paraqitjes së argumenteve, të menduarit në mënyrë të pavarur, kritike dhe në terma abstrakte, pjesëmarrja në mënyrë aktive në dialogun reflektues, vënia e njohurive teorike në praktikë, të dëgjuarit e të tjetrit/tjerëve- dhe marrja pjesë në biseda eksploruese dhe pa paragjykime. Mësuesit marrin orientim të posaçëm se cilat kompetenca duhen zhvilluar për çdo lëndë. 'Demokracia' përmendet jo më pak se 17 herë në kurrikulën e shkollës fillore dhe 'Ndikimi i nxënësit', 14 herë. Paragrafi 2.3 trajton posaçërisht 'përgjegjësinë dhe ndikimin e nxënësve' (shih kutinë me tekst më poshtë)

Përgjegjësia dhe ndikimi i nxënësve

"Tre parimet demokratike: të kesh mundësi të ndikosh; të marrësh përgjegjësi; të marrësh pjesë duhen përqafuar nga të gjithë nxënësit. Nxënësit inkurajohen vazhdimisht për të marrë pjesë aktive në punën për zhvillimin e mëtejshëm të arsimit dhe informohen për çështjet që kanë të bëjnë me ta, duke u krijuar mundësi të ndikojnë mbi arsimimin. Informacioni dhe format e ndikimit të nxënësve duhet të përshtaten sipas moshës dhe pjekurisë. Nxënësve iu jepet gjithnjë mundësia për të ndërmarrë nisma për çështje, që trajtohen në kuadrin e ndikimit të tyre mbi arsimin.

Objektivi i shkollës është që çdo nxënës:

- përmes përpjekjeve dhe pjesëmarrjes të tij/saj, sipas kushteve në të cilat gjendet, të marrë përgjegjësi për të nxënësit e tij/saj dhe të kontribuojë për një mjedis të favorshëm pune,
- të tregojë respekt dhe vlerësim ndaj personelit të shkollës dhe nxënësve të tjerë, si pjesë e përgjegjësisë së përbashkët për mjedisin e punës në shkollë,
- të ushtrojë në mënyrë konstante një ndikim gjithnjë e më të madh mbi arsimimin e tij dhe punën brenda shkollës,
- të marrë njohuri mbi parimet e demokracisë dhe të zhvillojë aftësinë e tij/saj për të punuar përmes formave demokratike.

Burimi: Paragrafi 2.3 në kurrikulën e shkollës fillore (fq. 22)

Për sa i takon kurrikulës së shkollës së mesme, në pjesët hyrëse të saj përcaktohen një sërë kompetencash themelore për qytetarinë demokratike. **Objektivat gjithëpërfshirëse për “njohuri”** (në të gjitha lëndët) janë formuluar me idenë që shkollat kanë përgjegjësi që të gjithë studentët individualë:

- të përmbushin parakushtet për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse në jetën shoqërore dhe atë të punës dhe
- të zotërojnë aftësinë për të shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë kritike atë që shohin, dëgjojnë dhe lexojnë, që të jenë në gjendje të diskutojnë dhe të formojnë pikëpamje rreth çështjeve të ndryshme që lidhen me jetën dhe vlerat.

Sa u takon **“normave dhe vlerave”**, ka gjithashtu një sërë objektivash kryesore, si: aftësia për të përcaktuar në mënyrë të ndërgjegjshme mendimin, për të respektuar dhe ndërevepruar me të tjerët, për të refuzuar shtypjen dhe trajtimin degradues, për të shprehur empati, për të kuptuar të tjerët dhe për të treguar respekt e për t’u kujdesur për mjedisin rrethues dhe për mjedisin në një kuptim më të gjerë.

Më poshtë paraqiten disa shembuj të përfshirjes dhe zhvillimit të kompetencave demokratike në kurrikulën shkollore. Shkencat shoqërore (*qytetaria, historia, besimi fetar dhe gjeografia*) luajnë rol kyç në përfitim të njohurive rreth proceseve demokratike, por shumica e lëndëve nuk përmbajnë referenca për zhvillimin e kompetencave themelore për qytetarinë demokratike.

Edukimi qytetar – më shumë sesa vetëm marrje njohurish: Kurrikula për mësimdhënien në qytetari (shkolla fillore) përfshin referenca konkrete të njohurive mbi demokracinë, si për shembull: mësimi për parlamentin suedez, mënyrën sesi individë dhe grupe mund të ndikojnë në vendime, idetë politike, zgjedhjet dhe partitë etj., por edhe mbi synimin kryesor për të ndihmuar nxënësit të zhvillojnë njohuritë rreth mënyrës sesi individë dhe shoqëria ndikojnë te njëri-tjetri. Për më tepër, qytetaria duhet t’u krijojë nxënësve kushtet për t’i parë çështjet shoqërore nga këndvështrime të ndryshme, si dhe instrumentet për të menaxhuar informacionin në jetën dhe studimet e përditshme, duke përfshirë këtu njohuri rreth mënyrës si ta kërkojnë dhe vlerësojnë informacionin mbi shoqërinë nga burime të ndryshme. Po kështu, kurrikula përcakton se mësimdhënia e qytetarisë duhet t’i ndihmojë nxënësit të përftojnë aftësinë për të reflektuar mbi vlerat dhe parimet që dallojnë një shoqëri demokratike. Përveçse të mësojnë rreth demokracisë, të shqyrtojnë në mënyrë kritike dhe të reflektojnë, nxënësit duhen nxitur edhe të përfshihen e të marrin pjesë në shkëmbime të hapura pikëpamjesh mbi çështjet shoqërore.

Kompetencat demokratike përfshihen dhe nxiten përmes lëndëve të ndryshme. Zhvillimi i kompetencave komunikuese, të tilla si: të dëgjuarit, të folurit, marrja pjesë në bashkëbisedime dhe diskutime përfshihen në të gjitha kurrikulat gjuhësore, si për arsimin e detyrueshëm, ashtu edhe për atë të mesëm të lartë. Aftësia për të vlerësuar në mënyrë kritike dhe për të menaxhuar një fluks konstant informacioni, ku bëjnë pjesë burimet e kritikës dhe përdorimi i këndvështrimeve të ndryshme, janë kompetenca që mund të praktikohen në shumicën e lëndëve shkollore. Programet mësimore për shumë lëndë përfshijnë orientime të qarta për mësuesit lidhur me llojin e këndvështrimeve, që duhet të përfshijë mësimdhënia. Ky orientim duhet parë si ndihmë që mësuesit u japin nxënësve/studentëve për të reflektuar dhe pasuruar njohuritë e tyre, por edhe si një përgatitje e dobishme për të dëgjuar ligjërimin politik lidhur me temat e aktuale në shoqëri, duke i përgatitur të bëhen qytetarë aktivë. Më poshtë, paraqiten shembuj nga programi mësimor i disa lëndëve (përveç qytetarisë) për klasën 7-9 -të:

- Mësimi i **historisë** përfshin tema mbi krijimin e Kombeve të Bashkuara, konceptin e të Drejtave të Njeriut dhe Konventës së të Drejtave të Fëmijës.
- Mësimi i **biologjisë** duhet të trajtojë çështje shoqërore aktuale që përfshijnë biologjinë, ndikimin e njerëzve në natyrë në nivel lokal dhe global, si dhe diskutimet publike për larminë biologjike, për shembull, marrëdhënia midis pylltarisë dhe gjuetisë.
- Mësimi në **fizikë** duhet të trajtojë furnizimin dhe përdorimin e energjisë në këndvështrimin historik dhe aktualisht, në ditët tona, si dhe mundësitë dhe kufizimet në të ardhmen, aq më shumë, në raport me ndryshimin e klimës.

- Mësimdhënia në **kimi** merret me përdorimin e energjisë dhe të burimeve natyrore nga njerëzit në shkallë lokale dhe globale, si dhe me domethënien e konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm.
- Mësimdhënia në **gjeografi** duhet të trajtojë se ku prodhohen dhe konsumohen mallrat dhe shërbimet e ndryshme, emigracionin e urbanizimin, si dhe shkaqet dhe pasojat e tyre.
- Mësimi i **fesë** në shkollë laike mbulon të gjitha besimet fetare, pa preferenca për një besim të caktuar.
- Mësimdhënia në **teknologji** kap aspekte të teknologjive të reja për menaxhimin e mbetjeve dhe riciklimin.
- Mësimdhënia e **ekonomisë shtëpiake** trajton gjurmën globale për llojet e ndryshme të ushqimeve dhe mënyrën si mund ta zvogëlojmë atë, për shembull, duke ngrënë më pak mish, duke ulur mbetjet ushqimore dhe duke konsumuar ushqimin e prodhuar në nivel lokal.

3.4 Shkollat kanë mision të mbrojnë demokracinë në mënyrë aktive

Akti për Arsimin dhe kurrikula përcaktojnë qartësisht se **askush nuk duhet të bëhet objekt i diskriminimit** ose i trajtimeve të tjera denigruese, për shkak të orientimit seksual, identifikimit apo shprehjes si transgjitor, besimit fetar apo bindjeve të tjera, aftësisë së kufizuar apo moshës. Të gjitha këto prirje duhen luftuar në mënyrë aktive. *Agjencia Kombëtare e Arsimit* shprehet se diskriminimi, ksenofobia dhe mungesa e tolerancës duhen përballur me dije, diskutim të hapur dhe masa aktive, në mënyrë që të garantohet një mjedis shkollor i sigurt, ndërkulturor dhe gjithëpërfshirës për të gjithë nxënësit dhe studentët.

Misioni i përcjelljes së parimeve dhe vlerave demokratike në praktikë nënkupton se shkollat nuk janë asnjëherë në raport me to. Mendimet ndryshe dhe diskutimi i hapur duhet të jenë të mirëpritura dhe **shkollat nuk duhet të jenë asnjëherë asnjëherë, por t'i mbrojnë vlerat demokratike**. Rezultati i kësaj është që askush nuk duhet të diskriminohet dhe se ksenofobia dhe racizmi duhen përballur me informim, njohuri dhe diskutim. Edhe pse nxënësit dhe studentët mund të kenë mendime ose pikëpamje jodemokratike, shkollat duhet të mbështetin e të përcjellin gjithnjë të drejtat e njeriut dhe vlerat demokratike. Personeli shkollor ka përgjegjësinë të reagojë dhe të distancohet nga çdo vlerë dhe mendim që bie ndesh me vlerat themelore demokratike.

Çdokush në shkollë ka të drejtë të trajtohet me respekt, Diskriminimi, ngacmimi dhe bullizmi janë shembuj të qartë të sjelljes që bie në kundërshtim me vlerat demokratike dhe që kërkojnë reagim dhe veprim nga ana e mësuesit. Mësuesi kujdestar dhe pushteti vendor kanë **përgjegjësi të hetojnë dhe të veprojnë**, në rast se një nxënës ose student bullizohet ose bëhet objekt diskriminimi. Fëmijët dhe studentët kanë mundësi gjithashtu që të raportojnë për bullizmin dhe sjelljen abuzive të *Përfaqësuesit i Fëmijës dhe Studentit të Shkollës*, një organizëm që lidhet me inspektoratin suedez të shkollave, misioni i të cilit është të mbrojë të drejtat e fëmijëve dhe studentëve të shkollave. Mësuesi mund të ndiqet penalisht për bullizëm dhe sjellje abuzive.

Herë pas here, çështje të caktuara mund të ndezin ndjenja të forta dhe të krijojnë tensione të ashpra në klasë, me të cilat mësuesit duhet të përballen. *Agjencia Kombëtare e Arsimit* shprehet se studentët duhet të kenë hapësirën e duhur për të diskutuar çështje të ndjeshme e shqetësuese, edhe nëse janë të debatueshme. Mësuesit inkurajohen të punojnë së bashku për të zhvilluar aftësinë e drejtimit të diskutimeve të tilla të promovimit të vlerave demokratike, pasi janë pjesë jetike e detyrës së shkollës. **Të flasësh për çështje të debatueshme, për politikën dhe vlerat demokratike mund të jetë sfiduese dhe kërkon më shumë nga aftësitë sesa ato të mësimdhënies.** Një sërë entesh qeveritare kanë hartuar paketa dhe instrumente pedagogjike që mund të përdoren nga mësuesit, kur japin mësim lidhur me demokracinë, politikën dhe çështjet të tjera të debatueshme (shih kapitullin 4 për shembuj dhe praktika). *Agjencia e Rinisë dhe Shoqërisë Civile* thekson gjithashtu nevojën që mësuesit të kenë kurajë ta shohin me kujdes nga vetja, kur planifikojnë të flasin e të drejtojnë diskutime mbi demokracinë dhe vlerat demokratike me studentët dhe të praktikojnë të menduarit kritik me ta. Kjo agjenci ka prezantuar metodën pedagogjia normë-kritikë, një proces sa individual, ashtu edhe kolektiv, që mund të jetë i favorshëm për të nxjerrë në pah normat dhe stereotipat.

Burimet që mund të përdorin mësuesit në edukimin për qytetari demokratike nuk kufizohen tek agjencitë qeveritare. Mësuesit mund të përdorin, për shembull, materiale të prodhuara nga organizata të ndryshme të shoqërisë civile. Atyre iu lehtësohet puna, kur klasa vendos të mbështetë një fushatë të caktuar, si, për shembull, mbledhja e fondeve për fëmijët e varfër ose fëmijët e ekspozuar ndaj luftës. Një shembull i fundit lidhet me mbledhjen e fondeve në mbështetje të Ukrainës, nga shumë shkolla, përmes Kryqit të Kuq apo UNHRC-së. Kjo është gjithashtu një mundësi për mësuesit që të shpjegojnë temën e luftës, rëndësinë e përkrahjes së vlerave demokratike, etj.

3.5 Pjesëmarrja dhe ndikimi në kontekstin e shkollës

Ndikimi i nxënësve dhe studentëve rregullohet nga legjislacioni dhe kurrikula suedeze. Ligji suedez për Arsimin përcakton se nxënësit/studentët duhet të kenë mundësi të ushtrojnë ndikim mbi arsimimin e tyre. Më konkretisht, ata duhet të inkurajohen vazhdimisht të marrin pjesë aktive në punën për zhvillimin e mëtejshëm të arsimit dhe duhet të informohen për çështjet që u takojnë atyre. Kështu, **ndikimi i nxënësve dhe studentëve mbi aktivitetet e mësimdhënies në shkolla nuk është privilegj, por një e drejtë**. Një ndikim i tillë mund të ushtrohet gjatë veprimtarisë së përditshme dhe të marrë një formë të strukturuar. Gjithashtu, ajo mund të shtrihet edhe te rregullat që duhen zbatuar, kur studentët ndahen në grupe, si dhe në rastet kur ata ndërmarrin nisma për çështje me rëndësi në kuadrin e ndikimit të tyre mbi arsimimin.

Të gjitha shkollat duhet të kenë një apo disa forume për ndikimin dhe këshillimin me studentët. Këto forume organizohen shpesh në formën e këshillave të klasës dhe shkollës, të bashkimeve të studentëve dhe përfaqësuesve të sigurisë për studentët. Shkollat duhet të mbështetnin dhe lehtësojnë punën e këshillave të shkollës dhe shoqatave të tjera me rol ndikues. Përmes pjesëmarrjes dhe ndikimit, nxënësit dhe studentët mund të zhvillojnë aftësinë e tyre për të ndikuar dhe për të marrë përgjegjësi, si dhe për të mësuar, nëpërmjet përvojës, rreth demokracisë. Në këtë mënyrë promovohet edhe angazhimi dhe rritja e aftësisë së të nxënësve. Mekanizmat për pjesëmarrje dhe ndikim duhen përshtatur në përputhje me moshën dhe pjekurinë. Fushat e ndikimit lidhur me aktivitetet e mësimdhënies në shkolla mund të përfshijnë materialet e të nxënësve, **që duhen përdorur**, renditjen dhe kohën e detyrave të ndryshme, cilat metoda pune duhen zbatuar dhe si duhen raportuar detyrat e caktuara. Aspekte të tjera, ku nxënësit dhe fëmijët mund të ushtrojnë ndikim, përfshijnë mjedisin e shkollës, aktivitetet gjatë pushimeve dhe aktivitete të tjera shkollore, ku bëjnë pjesë edhe organizimet sociale dhe lojërat.

Pjesëmarrja e nxënësve/studentëve organizohet shpesh në formën e **këshillave të klasës**, të cilat mbledhen nga mësuesi rregullisht (shpesh, çdo javë), si një hapësirë për të diskutuar tema që lidhen me aktivitetet e mësimdhënies që janë në zhvillim e sipër dhe për informacione rreth aktiviteteve në nivel shkolle. Këshillat e klasave përbëjnë një mundësi të drejtpërdrejtë për nxënësit dhe studentët që të ndikojnë mbi aktivitetet shkollore, duke diskutuar e bashkëndarë pikëpamjet sa edhe duke dhënë sugjerime. Klasa zgjedh 1-2 nxënës/studentë për të përfaqësuar klasën në këshillin e nxënësve/studentëve në nivel shkolle. Këto këshilla mund të organizohen në mënyra të ndryshme dhe të mbledhen rregullisht, por jo aq shpesh sa këshillat e klasave. **Këshillat e nxënësve/studentëve përdoren për të diskutuar çështje me rëndësi**, të cilat mund të përfshijnë rregullat dhe praktikatat e shkollës, ushqimin, mjedisin e shkollës etj. Për më shumë hollësi dhe shembuj, shihni rubrikën 4.1. Në shkollat e mesme, është e zakonshme që studentët të organizohen në bashkime studentore. Në nivel kombëtar ka tri shoqata të ndryshme që ofrojnë mbështetje, materiale burimore dhe frymëzim për këshillat e nxënësve dhe të studentëve, ku përfshihet edhe shoqata që është përqendruar te forcimi i demokracisë në shkolla (shih Shtojcën 2).

Përveç ndikimit të nxënësve/studentëve, Ligji për Arsimin përcakton se shkollat duhet të kenë një ose disa forume për **konsultimin me prindërit/kujdestarët** për çështje me rëndësi. Zakonisht, zgjidhen një ose dy prindër/kujdestarë për klasë nga të gjithë prindërit që kanë fëmijët në atë klasë. Shkollat mbajnë përgjegjësi për të informuar vazhdimisht kujdestarët rreth zhvillimit të nxënësve dhe mësuesve. Praktikisht, kjo organizohet shpesh në formatin e takimeve midis nxënësve/studentëve, kujdestarit/kujdestarëve dhe mësuesit/mësuesve për të diskutuar ecurinë, si edhe

mirëqenien dhe mënyrën si nxënësi/studenti përjetojnë mjedisin shkollor, mësimdhënien dhe aktivitetet e tjera. Gjithashtu, prindërve/kujdestarëve u duhen ofruar mundësi këshillimi dhe ndikimi lidhur me arsimin dhe aktivitetet e zhvillimit të cilësisë. Nëse prindërit/kujdestarët nuk e miratojnë mënyrën sesi drejtohet shkolla, ata mund t'i raportojnë për këtë *Inspektoratit Suedeze të Shkollave*.

Shkollat e zhvillojnë në mënyra të ndryshme përgjegjësinë për të informuar dhe ofruar mundësi prindërve për të ushtruar ndikimin e tyre. Një nga mënyrat është organizimi i këshillave të prindërve, me përfaqësues të prindërve, që takohen me drejtorin dhe Bordin e shkollës disa herë brenda vitit shkollor. Këshilli është një mekanizëm dialogu, informimi dhe këshillimi. Për takimet midis shkollës dhe prindërve caktohen përfaqësues nga prindërit.

Nuk ka asnjë kërkesë ose model për ndërveprimin midis shkollave dhe bashkive ose për mënyrën sesi nxënësit/studentët mund të informohen dhe të angazhohen në demokracinë vendore. Bashkitë përdorin mënyra të ndryshme për të **informuar dhe angazhuar nxënësit/studentët në demokracinë vendore**. Si shembuj mund të përmendim takimin e nxënësve/studentëve me përfaqësues të pushtetit vendor për të mësuar më shumë rreth vendimmarrjes dhe ndikimit qytetar në nivel bashkiak. Të tilla takime kombinohen ndonjëherë me diskutime për çështje të veçanta, për të cilat nxënësve/studentëve u kërkohet të shprehin pikëpamjet dhe sugjerimet e tyre. Disa bashki kanë ngritur mekanizma më formale për të ndërvepruar me fëmijët dhe të rinjtë, duke angazhuar në mënyrë të përsëritur përfaqësuesit e këshillave të nxënësve. Ashtu siç përmendet në kapitullin e 2-të, buxheti me pjesëmarrje nuk është praktikë e përhapur në bashkitë suedeze, megjithatë ka shembuj të bashkive që kanë angazhuar shkollat në buxhetimin me pjesëmarrje. (Rubrika 4.3). Për sa i takon angazhimin e të rinjve në demokracinë vendore, *Agjencia Suedeze e Rinisë dhe Shoqërisë Civile* ka përgjegjësi të hartojë modele pune për bashkitë që të promovojnë njohuritë dhe angazhimin (shih rubrikën 4.2.3).

3.6 Kërkimi shkencor dhe rezultatet e kërkimit shkencor në edukimin për qytetari demokratike

Suedia ka marrë pjesë në Studimin Ndërkombëtar për Edukim Civil dhe Qytetar, SNCQ, në vitin 2009 dhe 2016. SNCQ-ja përmban një **studim krahasues të njohurive, qëndrimeve dhe vlerave të studentit** lidhur me demokracinë dhe qytetarinë, si dhe me angazhimet e tyre aktuale dhe të ardhshme ndaj shoqërisë. Studimi është përqendruar te arsimi i lartë i detyrueshëm (klasa 8), prej të cilit vetëm dy vende, Danimarka dhe Tajvani, kanë dalë më mirë se Suedia. Rezultatet suedeze në raport me njohuritë treguan përmirësim domethënës në vitin 2016, krahasuar me rezultatet e SNCQ-së në vitin 2009. Rezultatet e anketimit treguan se studentët suedeze shprehnin mbështetje të fortë për barazinë gjinore, pakicat etnike dhe mundësitë e barabarta.

Në këndvështrimin krahasues, rezultati suedeze ka qenë pozitiv. Megjithatë, disa studime tregojnë se ka hapësirë për përmirësime në mënyrën sesi organizohet dhe realizohet edukimi demokratik në shkollat suedeze, por edhe në lidhje me mbështetjen dhe burimet për shkollat dhe mësuesit. Në vitin 2012, *Inspektorati Suedeze i Shkollave* kreu **vlerësimin e cilësisë** të 17 shkollave të arsimit të detyrueshëm të përzgjedhura në mënyrë rastësore, i cili tregoi se shumica e shkollave prirën ta realizojnë edukimin demokratik përmes tri rrugëve: zhvillimit të njohurive rreth demokracisë; promovimit të vlerave demokratike; nxitjes së qytetarisë demokratike. Gjetjet treguan nevojën për rritjen e integritit të edukimit demokratik me praktikën në të gjitha lëndët shkollore, për të forcuar kapacitetin e nxënësve për qytetari aktive për sa u përket njohurive, vlerave dhe aftësive. Për më tepër, Inspektorati bëri thirrje për rritjen e vëmendjes ndaj pjesëmarrjes dhe ndikimit të nxënësve, për t'u siguruar që të gjithë nxënësit të përfitojnë nga mundësia për të praktikuar shprehjen e mendimeve dhe pikëpamjeve të tyre përballë të tjerëve. Në vitin 2021, *Bashkimi Kombëtar i Mësuesve* paraqiti një **raport mbi edukimin demokratik** në shkollat fillore dhe të mesme. Ai doli në përfundimin se, përgjithësisht, ka një angazhim të lartë mes mësuesve dhe misioni demokratik i shkollave kuptohet mirë. Shumica e mësuesve ishin të kënaqur me kontributet e tyre individuale, gjë që u konfirmua nga nxënësit dhe studentët, që u shprehën se kishin rritje të njohurive dhe njëherësh se ishin frymëzuar për qytetari aktive. Në të njëjtën kohë, mësuesit

dhe studentët në programet e formimit profesional ishin më pak të kënaqur. Raporti nxori në pah edhe sfidat dhe kufizimet e përgjithshme lidhur me mënyrën e organizimit të edukimit demokratik dhe nevojën për orientim, burime dhe mbështetje të mëtejshme.

Përgjatë viteve, *Agjencia Kombëtare e Arsimit* ka shpërndarë **rezultate nga përmbledhjet e kërkimeve shkencore**. Të dhënat tregojnë rezultate të qarta pozitive të **mësimdhënies përmes demokracisë**, duke angazhuar studentët të marrin pjesë dhe që ndikojnë nëpërmjet proceseve demokratike në nivel shkolle, përfshi përfaqësimin e klasës së tyre, pjesëmarrje në këshilla dhe unione etj. Gjetjet tregojnë se **përvoja praktike e proceseve demokratike në shkollë ka një korrelacion pozitiv me pjesëmarrjen politike dhe besimin tek institucionet politike**. Hulumtimet për zhvillimin dhe nxitjen e vlerave kanë theksuar nevojën që shkollat të kenë një qasje të përbashkët, duke përdorur disa metoda dhe qasje. Në studimin modern të demokracisë, komunikimi theksohet shpesh si shtylla kryesore e demokracisë dhe në këndvështrimin pedagogjik, i ashtuquajtur dialog diskutues (eksplorues) theksohet si një qasje mjaft e dobishme. Dialogu diskutues mund të përdoret në të gjitha lëndët, kur diskutohen dhe ballafaqohen këndvështrime të ndryshme lidhur me një çështje/problem, duke përdorur një mënyrë komunikimi të hapur, tolerante dhe me respekt ndaj njëritjetrit, si dhe duke eksploruar argumente të ndryshme.

Instituti Kërkimor Suedez i Arsimit ka identifikuar kohët e fundit nevojën për njohuri të orientuara më shumë nga praktika për mësimin e demokracisë. Në këtë pikë, mësuesit janë shprehur për sfida në trajtimin e profileve të ndryshme kulturore, vlerave jodemokratike dhe në mbështetjen e nxënësve për të qenë të pavarur. Në vijim, Instituti nisi **një shqyrtim sistematik të studimeve ndërkombëtare mbi mësimin e demokracisë** me qëllimin për t'u ofruar mësuesve njohuri të mbështetura mbi të dhëna sesi të mësojnë demokracinë, si dhe efektet e qasjeve të ndryshme të mësimdhënies. Shqyrtimi do të finalizohet në dhjetor 2022.

4. EDUKIMI PËR QYTETARI DEMOKRATIKE – SHEMBUJ TË PRAKTIKAVE, NISMAVE, BURIMEVE DHE BASHKËPUNIMIT/EVE

Ashtu siç u trajtua në rubrikat e mëparshme, misioni për demokracinë i shkollave suedeze është i gjerë dhe duhet të përshkojë të gjitha funksionet dhe aktivitetet në kontekstin e shkollës. Në të njëjtën kohë, misioni përkufizohet si nxënia dhe zhvillimi nga fëmijët dhe të rinjtë i kompetencave të caktuara demokratike. Ka disa mënyra për ta bërë këtë. Në këtë kapitull paraqiten një përzgjedhje shembujsh të praktikave, nismave, burimeve të të nxënësve dhe qasjeve metodologjike. Ato përfaqësojnë shembuj sesi mund të marrin pjesë e të ndikojnë nxënësit dhe studentët në aktivitetet në nivel shkolle dhe në nivel të pushtetit vendor. Ka po ashtu shembuj të burimeve të të nxënësve dhe paketave të mësimdhënies që janë në dispozicion të mësuesve në punën e tyre. Disa nga shembujt ilustrjnë praktika të përgjithshme si pjesëmarrja e nxënësve/studentëve në nivel shkolle, shembuj të tjerë paraqesin aktivitete si zgjedhjet në shkollë dhe, më pas, ka një sërë shembujsh të nismave dhe aktiviteteve që ilustrjnë praktikën që mund të duken pak ndryshe në bashki të ndryshme dhe burimet e qasjes që janë në dispozicion të mësuesve, por nuk janë të detyrueshme.

4.1 Pjesëmarrja dhe ndikimi në nivel shkolle

Pjesëmarrja dhe ndikimi i nxënësve dhe studentëve rregullohet nga legjislacioni dhe kurrikula suedeze. Nxënësit dhe studentët kanë të drejtën të ndikojnë në aktivitetet e mësimdhënies në shkollë (si organizohet mësimdhënia/mësimnxënia), aktivitete të tjera shkollore (ditë tematike, lojëra, sfida etj.) dhe në mjedisin e shkollës (siguria dhe aktivitetet gjatë pushimeve). Ashtu siç theksohet në kapitullin 3, pjesëmarrja dhe ndikimi duhen organizuar në forume të ndryshme, si këshillat e klasave dhe këshillat e nxënësve/studentëve. Më poshtë janë disa shembuj në praktikë.

4.1.1 Këshillat e klasës dhe këshillat e nxënësve në praktikë

Këshillat e klasës dhe këshillat e nxënësve/studentëve mund të organizohen në mënyra të ndryshme. Këshillat e nxënësve janë futur tashmë që në vitet e para të shkollës fillore. Përveç mbështetjes nga personeli shkolle, janë edhe organizatat kombëtare për nxënësit dhe studentët (shtojca 2) që ofrojnë mbështetje dhe orientim për nxënësit dhe studentët, të cilët janë të angazhuar apo duan të angazhohen në ushtrimin e ndikimit në aktivitetet shkollore. Më poshtë janë dy shembuj ilustrues të këshillave të klasës dhe këshillit të nxënësve në një shkollë fillore (klasat 1-6).

Shembull i një mbledhjeje të këshillit të klasës (klasa e dytë e shkollës fillore). Një nxënës caktohet si kryetar për vitin dhe mësuesi/ja është sekretari/ja.

1. Hapet mbledhja.
2. Çfarë është këshilli i klasës? (Mësuesi/ja ia shpjegon klasës)
3. Pyetje dhe komente (nxënësit ngrenë çështjet për diskutim)
 - Duam një rregullim x në sheshin e lojërave të shkollës (Mësuesi/ja do të flasë me edukatorët e argëtimit)
 - Duam një fushë futbolli dhe portë më të madhe. (Mësuesi/ja shpjegon se oborri i shkollës nuk do t'i nxinte)

- Disa orë janë shumë të shkurtra, për shembull, kur punojmë me x (Mësuesi/ja bie dakord të rregullojë orarin)
- Shprehet dëshira për më shumë punë me kompjuterin dhe artin në aktivitetet javore ndërkurrikulare (Mësuesi/ja bie dakord të marrë në konsideratë idenë në planifikim)

Përpara përfundimit të mbledhjes, të gjithë nxënësit marrin një copë letër, ku mund të shkruajnë propozime dhe ide për këshillin tjetër të klasës dhe e hedhin letrën në “kutinë e sugjerimeve”.

4. Mbledhja mbyllet. Mbledhja tjetër pas një muaji.

Shembull: si e ka organizuar një shkollë (klasa 1-6) Këshillin e vet të Nxënësve. Çdo klasë zgjedh dy përfaqësues, një të përhershëm dhe një me rotacion. Ata e përfaqësojnë klasën gjatë gjithë vitit shkollor, por ndryshojnë rolet pas një semestri, i përhershmi bëhet me rotacion dhe anasjelltas. Përfaqësuesi i klasës do të marrë pjesë në Këshillin e Nxënësve dhe Këshillin e Ushqimit. Përfaqësuesit duhet të jenë të vetëdijshëm se mund të humbasin ndonjë orë mësimi, kur marrin pjesë në mbledhjet e këshillit. Përfaqësuesit inkurajohen të jenë krijues, të përgjegjshëm dhe të interesuar dhe të praktikojnë të qenit dëgjues të mirë. Mbledhjet e Këshillit mbahen njëherë në muaj në dy grupe: një për vitin 1-3 dhe një për vitin 4-6. Për të pasur një diskutim më të përqendruar, shkolla ka vendosur t’i organizojë takimet lidhur me tema të ndryshme:

- shtator: nis shkolla/detyrat e shtëpisë/provimet/java e miqësisë
- tetor: vlerësimet dhe dialogu rreth ecurisë
- nëntor: siguria/mirëqenia/mbështetja
- shkurt: blerje/aktivitete në pushimet e mëdha e të vogla
- mars: mjedisi
- prill: rregullat e shkollës
- maj: vlerësimi

Përfaqësuesit duhet të diskutojnë temat mujore në klasat përkatëse përpara sesa të marrin pjesë në këshillin e nxënësve.

4.1.2 Forumi i demokracisë – një hapësirë takimi për temat e vështira në shkollë

Fondi suedez për Trashëgiminë mbështet një projekt (2021-2024), që duhet Forumi i Demokracisë (Demokratiforum). Qëllimi i projektit është të nxitë një mjedis më të mirë pune, fizik dhe psikosocial, për të gjithë në shkollat suedeze. Vëmendja përqendrohet te hartimi i një metode të re, e ashtuquajtur Forumi i Demokracisë, një hapësirë takimi për dialog lidhur çështje të vështira dhe të ndjeshme, si diskriminimi, ngacmimi, problemet e shëndetit mendor etj. Federata suedeze e Nxënësve dhe Studentëve, e cila ka si mision promovimin shkollave më të mira dhe më demokratike, luan rol qendror në proces, së bashku me shkollat në mbarë Suedinë. Ideja e zhvillimit të demokracisë në shkollë përmes “Forumeve Demokratike”, u prezantua pas konsultimit me mësuesit, drejtorët dhe nxënësit, të cilët kërkuar një hapësirë takimi për dialog.

Procesi i zhvillimit të metodës kryhet së bashku me një grup shkollash dhe një grup reference me përfaqësues të autoriteteve dhe organizatave me përgjegjësi lidhur me arsimin. Metoda supozohet të përdoret në shkollat fillore (klasa 7-9) dhe në shkollat e mesme. Ideja është se shkollat do të kenë mundësi të organizojnë Forume Demokratike me mbështetje nga materialet udhëzuese dhe videot mësimore. Federata e Nxënësve dhe Studentëve do të administrojë dhe do të ofrojë mbështetje për shkollat kur periudha e projektit të përfundojë.

4.2 Shkëmbimi dhe angazhimi me përfaqësuesit e pushtetit vendor

Më poshtë janë disa shembuj modalitetesh të ndryshme të ftesës, takimit dhe angazhimit me nxënësit dhe studentët dhe të dhënies së propozimeve nga nxënësit dhe studentët për t'u zbatuar në nivel lokal ose të përdoren si këshillim për politikanët vendorë.

4.2.1 Bashkitë janë aktive për t'u takuar e për të angazhuar nxënësit dhe studentët

Bashkitë suedeze angazhohen me shkollat, nxënësit dhe studentët në mënyra të ndryshme. Më poshtë është një përzgjedhje e shembujve për të dhënë një ilustrim të larmisë së qasjeve të përdorura.

Nxënësit takojnë anëtarë të Asamblesë Bashkiake: Në Bashkinë Eda (rreth 8 500 banorë), Asambleja Bashkiake ka ftuar të gjithë nxënësit e klasës së 8-të për të marrë pjesë në një prej mbledhjeve të Asamblesë. Nxënësit u takuan me përfaqësuesit e zgjedhur dhe personelin e bashkisë dhe u informuan rreth organizimit politik të bashkisë dhe rreth bashkisë si punëdhënëse. Nxënësve iu kërkuar të bënin një "propozim nga qytetarët" për klasë. Sipas kryetarit të Asamblesë, bashkëpunimi me shkollat është i rëndësishëm për të nxitur një interes e pjesëmarrje më të madhe nga qytetarët e rinj në demokracinë vendore.

Këshilli i Nxënësve takohet me anëtarë të Komisionit Ekzekutiv Bashkiak të Arsimit: Në Hallsberg (rreth 16 300 banorë), Anëtarët e Komisionit Ekzekutiv Bashkiak të Arsimit ftuan Këshillin e Nxënësve të një prej shkollave fillore (klasa 1-6) në mbledhjet e tyre të rregullta. Mbledhja u organizua pas kërkesës nga kryetari dhe sekretari i Këshillit të Nxënësve. Për përgatitjen e takimit, këshillit iu desh të mbledhte pyetjet nga të gjitha klasat dhe e shfrytëzoi mbledhjen për t'i ngritur të gjitha pyetjet. Më pas, ata ndanë përvoja përmes një filmi të shkurtër në faqen e tyre lokale të internetit.

Asambleja e Nxënësve si këshill konsultativ: Bashkia Lidingö, Rajoni i Madh i Stokholmit (rreth 44 500 banorë). Bashkia ftoi të gjitha shkollat për të dërguar dy përfaqësues nga këshillat përkatës të nxënësve (shkolla fillore, klasat 4-9), për të marrë pjesë në një takim midis nxënësve dhe Asamblesë, për të vepruar si një këshill konsultativ për politikanët vendorë. Në mbledhjen e parë, vëmendja u përqendrua te diskutimi i formave të punës dhe i mënyrës sesi të ishte një këshill konsultativ për politikanët në Lidingö.

Një Këshill i Gjelbër i Nxënësve që punon për vizionet për bashkinë: Bashkia Malmö (rreth 345 000 banorë) është angazhuar për hartimin e një metode të re për angazhimin e të rinjve në çështjet mjedisore përmes Këshillit të Gjelbër të Nxënësve. Nisma synonte klasën 7-8 në katër shkolla fillore, ku nxënësit kishin punuar për çështjet e mjedisit dhe të klimës. Ata u takuan me zyrtarë vendorë në një seminar dhe reflektuan mbi vizionet e tyre për Bashkinë Malmö-s. Procesi solli si rezultat një dokument me vizionet dhe idetë e nxënësve, që u përdorën për hartimin e një programi të ri bashkiak për mjedisin. Nisma u zbatua me mbështetjen e Qendrës Ndërkombëtare suedeze për Demokraci Vendore.

Këshilli Qendror i Nxënësve që lidh nxënësit me vendimmarrësit e zgjedhur: Bashkia e Malmö-s ka organizuar Këshillin qendror të Nxënësve si lidhje midis Këshillave të Nxënësve dhe vendimmarrësve. Këshilli përbëhet nga 14 përfaqësues (klasa 8 dhe 9) nga shkolla të ndryshme. Çdo përfaqësues ka një votë. Kur nxënësit nga klasa e 9-të përfundojnë arsimin fillor, angazhohen përfaqësues të rinj (klasa 8), duke synuar ato shkolla që nuk kanë qenë më parë pjesë e nismës. Qëllimi i Këshillit Qendror të Nxënësve është të rritë ndikimin e nxënësve mbi çështje që lidhen me jetën e tyre të përditshme. Ideja e përgjithshme është që t'iu lehtësohet nxënësve dhënia e ideve dhe sugjerimeve mbi të cilat vendimmarrësit mund të vendosin dhe që të përdoret Këshilli si organ referimi për administratën shkollore të bashkisë. Përfaqësuesit e sapoemëruar kanë theksuar se është e rëndësishme që shokët e klasës të informohen rreth nismës, që të kenë një zë dhe rreth faktit se Këshilli është një mundësi për të ushtruar ndikim deri në nivelet më të larta politike.

Dialogu midis studentëve dhe vendimmarrësve të zgjedhur: Bashkia Gislaved (rreth 30 000 banorë) ka organizuar një proces dialogu midis studentëve në shkollat e mesme të larta, vendimmarrësve vendorë dhe personelit bashkiak.

Procesi përfshin disa hapa; së pari, politikanët vendorë dhe personeli vizitojnë shkollat e mesme dhe takohen me studentët, të cilët informohen rreth vendimmarrjes në bashki. Gjatë vizitës, studentët marrin një çështje apo temë për të punuar për disa javë, përpara sesa të takohen sërish me vendimmarrësit për të zhvilluar një dialog ku marrin kontribute nga studentët. Qëllimi i procesit është të lehtësojë shkëmbimin dhe të nxënit midis studentëve dhe vendimmarrësve, të nxitë angazhimin midis të rinjve në demokracinë vendore dhe të shtojë njohuritë e tyre mbi bashkinë. Procesi i dialogut ka angazhuar rreth 250 studentë dhe ka sjellë si rezultat një sërë propozimesh dhe përmirësimesh konkrete. Një prej vendimmarrësve tha: “Të rinjtë janë e ardhmja. Ka qenë shqetësuese të mos dinim si të ndërvepronim me ta, por në këtë mënyrë, e kemi bërë dhe ka qenë mjaft shpërblyese”. Nisma e procesit të dialogut me studentët është pjesë e një përpjekjeje më të madhe të bashkisë për të forcuar demokracinë vendore, duke dëgjuar pikëpamjet dhe idetë e qytetarëve.

Gjatë procesit të Dialogut me Studentët në Bashkinë Gislaved (më sipër), shumica e studentëve iu përgjigjën pyetjes: **“Si mund të ndërveprojë dhe të angazhojë Bashkia Gislaved më shumë të rinj në politikë dhe në çështjet politike?”**. Më poshtë janë disa prej përgjigjeve më të shpeshta:

- Më shumë takime fizike midis studentëve dhe politikanëve.
- Më shumë takime midis studentëve dhe politikanëve qysh në vitet e para të shkollës.
- Ftesa personale për takime me politikanët.
- Më shumë prani e politikanëve në shkolla “midis zgjedhjeve”.
- Sondazhe që përqendrohen te të rinjtë.
- Vëmendje më e madhe për thjeshtimin e gjuhës politike (gjuhës dhe të folurit të përditshëm).
- Vëmendje më e madhe për ta bërë politikën më argëtuese.
- Lidhje midis këshillit të studentëve dhe bashkisë/politikanëve.

Shembuj të çështjeve konkrete që studentët u ftuan të diskutojnë përfshijnë:

- “Në çfarë arti dhe kulture të re duhet të investojë bashkia Gislaved?”
- “Si duhet të punojnë sekretarët e terrenit në bashkinë Gislaved?”
- “Sëmundja/shëndeti mendor i të rinjve”.
- “Masat për parandalimin e aksidenteve rrugore dhe drejtimit të makinës në gjendje të dehur mes të rinjve”.
- “Cilat programe duhet t’u ofrohen shkollave të mesme të larta në Gislaved?”
- “Problemi i gjetjes me lehtësi të drogave”

4.2.2 “Çmimi i Demokracisë” për propozimet e shkollave sesi të forcohet demokracia

Përmes një marrëveshjeje me qeverinë suedeze në vitin 2020, Shoqata suedeze e Autoriteteve Vendore dhe Rajoneve (ShSAVR) u angazhua në një nismë për nxjerrjen në pah, mbrojtjen, forcimin dhe zhvillimin e demokracisë në Suedi. Vëmendja u përqendrua në tri fusha, përfshi pjesëmarrjen e qytetarëve, garantimin e dialogut demokratik dhe punën kundër forcave antidemokratike. Si pjesë e një game të gjerë veprimtarish, që përfshinë rreth 20 konferenca digjitale, ShSAVR-ja nxiti edhe shkollat të merrnin pjesë në procesin e Çmimit për Demokracinë, ku nxënësit e shkollave fillore (klasa 7-9) dhe studentët e shkollave të mesme u ftuan të jepnin ide dhe propozime për mënyrat sesi të forcohej demokracia. Çfarë mund të bëjmë për ta mbajtur demokracinë gjallë e të lulëzuar në 100 vitet e ardhshme? Çfarë mund të bëjmë që njerëzit të ndihen të përfshirë dhe të angazhuar? Si mund ta zhvillojmë demokracinë tonë?

Nxënësit dhe studentët u nxitën të përqendroheshin te propozimet mbi demokracinë vendore në bashki dhe rajone, por u ftuan po ashtu të jepnin ide në përgjithësi. U ngrit një juri për të përzgjedhur propozimet më të mira, që sollën si rezultat një sërë veprimtarish:

- Një Festival i Përhershëm i Poezisë, përfshi poezi sesi demokracia mund të përmirësohet dhe forcohet dhe seminare krijuese mbi të drejtat e fëmijës ku u angazhuam studentë të shkollave të mesme të larta dhe nxënësve të klasave 1-3.
- Punë eksploruese përmes filmave e lojërave, duke u përqendruar te demokratizimi në Suedi dhe në nivel ndërkombëtar, si dhe te të gjitha vlerat njerëzore.
- Një sondazh për demokracinë vendore, ndikimin dhe bashkëpunimin që iu drejtohej anëtarëve të një Asambleje Bashkiake, biznesit vendor dhe organizatave të shoqërisë civile.

Sipas ShSAVR-së, propozimet fituese treguan se pjesëmarrësit kishin përmirësuar njohuritë dhe aftësitë për qytetari aktive demokratike në një mënyrë krijuese. Po ashtu, ata vërtetuan se puna për forcimin e demokracisë mund të integrohet në shkolla dhe t'u ofrojë studentëve më shumë njohuri rreth demokracisë vendore.

4.2.3 Modelet e promovimit të njohurive të të rinjve për demokracinë vendore nga bashkitë

Në vitin 2020, Agjencia suedeze e Rinisë dhe Shoqërisë Civile u ngarkua nga qeveria të zhvillonte dhe shpërndante modele për mënyrën sesi bashkitë mund të rritnin njohuritë e të rinjve rreth demokracisë vendore. Kjo ishte pjesë e një nisme më të gjerë qeveritare, si pjesë e krenimit të 100 vjetëve demokraci suedeze në vitin 2021. Qëllimi i kësaj detyre ishte të kontribuohet për një demokraci të fortë duke zhvilluar kompetencat demokratike dhe duke rritur pjesëmarrjen. Fokusi është veçanërisht te promovimi i kushteve për të rinjtë, që, në mënyra të ndryshme, ndihen sikur janë të përjashtuar nga shoqëria e sotme. Procesi i zhvillimit të modeleve dhe metodave po zbatohet së bashku me aktorë të tjerë, në kontakt më të ngushtë me të rinjtë dhe me gjashtë bashki e një rajon përmes një marrëveshjeje pesëvjeçare. Pikënisja është përdorimi i një këndvështrimi rinor bazuar në të drejta. Në fazën hyrëse të projektit, Agjencia e Rinisë dhe Shoqërisë Civile trajnoi personelin e bashkive dhe rajonit pjesëmarrës.

4.3 Buxhetimi me pjesëmarrje dhe shkolla si arenë lokale

Rubrika e mësipërme tregoi një larmi shembujsh ndërveprimi midis nxënësve/studentëve dhe bashkive, përfshi dhënien e ideve dhe propozimeve për zbatim dhe për forcimin e demokracisë vendore. Qasja e buxhetimit me pjesëmarrje është njëfarësoj në përputhje me disa prej qasjeve të lartpërmendura, duke pasur, sidoqoftë, një qasje më të përcaktuar të dhënies së ideve dhe caktimit të përparësive mes tyre përmes votimit dhe me dallimin e qartë të përdorimit në raport me një buxhet të caktuar. Siç përshkruhet në kapitullin 2, buxhetimi me pjesëmarrje nuk është një dukuri e përhapur në Suedi. Megjithatë, ka shembuj lokalë të bashkive që angazhojnë shkollat dhe fëmijët/të rinjtë në proceset e buxhetimit me pjesëmarrje. Më poshtë jepen shembuj ilustrues të praktikave lokale të buxhetimit me pjesëmarrje, por edhe të përdorimit të shkollave si arena të angazhimit lokal.

Mjedisi dhe sportet lokale: Bashkia Örebro (rreth 157 000 banorë), gjatë periudhës 2009-2014, ka zbatuar tri procese të ndryshme të buxhetimit me pjesëmarrje, që kanë pasur në vëmendje fëmijët dhe të rinjtë. Bashkia u vu në kontakt dhe angazhoi të rinjtë përmes shkollave për proceset vijuese:

- Rreth 80 studentë nga tri klasa të shkollave të mesme u angazhuan në buxhetin e investimeve (rreth 25 000 euro) për trafikun dhe mjedisin. Studentët u angazhuan duke bërë propozime brenda kuadrit të buxhetit, duke marrë parasysh kostot. Propozimet shkonin nga korsitë e reja për biçikleta, te tabelat digjitale të informacionit e deri te fushat e volejbollit. Në një takim të përbashkët, studentët u lejuan të paraqisnin propozimet e tyre dhe, në votim, njëri prej propozimeve të tyre u zgjodh: rindërtimi i një zone argëtimi me një pishinë të jashtme. Investimi u ekzekutua po atë vit dhe studentët që e propozuan morën pjesë në përrurimin e pishinës.
- Rreth 100 studentë nga katër klasa të shkollave të mesme u angazhuan në buxhetin e investimeve (rreth 50 000 euro) të përcaktuar për Svartån-in (lumi që përshkon qytetin). Studentët u angazhuan për të paraqitur

propozime brenda buxhetit dhe në përputhje me disa prej kriterëve më poshtë: përmirësimi i aksesit në lumë apo pranë tij, krijimi i “disa përvojave argëtuese” përgjatë lumit ose përmirësimi i cilësisë së ujit për t’u larë apo për të pirë. Propozimet përfshinë ujin e pastër, rindërtimin e hapësirave të argëtimit përgjatë lumit Svartån, përmirësimin e aksesit duke përdorur një skelë druri. Në takimin e përbashkët u prezantuan të gjitha propozimet dhe nga votimi u zgjodh propozimi për ndërtimin e një skele druri në Svartån. Studentët që hartuan propozimin u përfshinë në procesin e zbatimit.

- Rreth 150 nxënës nga dy shkolla fillore u përfshinë në buxhetin e investimeve (rreth 80 000 euro) të dhënë për përmirësime në fushën e strehimit. Nxënësit u angazhuan për të reflektuar rreth asaj që do ta përmirësonte më shumë zonën dhe si mund të përmirësohej si për vajzat, ashtu edhe për djemtë. Pjesëmarrësit ranë dakord për një terren për sporte spontane, me bar artificial për futboll dhe basketboll. Përveç terrenit sportiv, ata identifikuan nevojën për ndriçim më të mirë, stola për spektatorët dhe pastrimin e disa shkurreve për ta bërë vendin më të hapur dhe ftues. Investimi do të kryhet vitin që vjen.

Një terren i ri lojërash: Bashkia Uddevalla (rreth 57 000 banorë) ka zbatuar dy procese buxhetimi me pjesëmarrje, që përfshijnë fëmijët dhe të rinjtë (2010-2013).

- Bashkia ftoi të rinjtë për të propozuar dhe votuar lidhur me mundësitë e përdorimit më të mirë të buxhetit prej 20 000 eurosh. Pati 21 propozime nga të cilat, fituesi ishte organizimi i një Dite të Komedisë.
- Si pjesë e procesit të investimit në një terren të ri lojërash, bashkia ftoi fëmijët (0-12) që jetonin aty afër dhe prindërit/kujdestarët e tyre për të marrë pjesë në procesin e buxhetimit, që përfshiu tre hapa. Së pari, fëmijët dhe prindërit/kujdestarët u ftuan të zgjidhnin pajisjet argëtuese që donin të kishin në sheshin e lojërave, duke përdorur një instrument pedagogjik në internet. Së dyti, bazuar në pajisjet e përzgjedhura të lojërave, departamenti teknik hartoi dy propozime konkrete. Së treti, pjesëmarrësit u ftuan në një takim, që u përqendrua te paraqitja dhe votimi i propozimeve. Në proces morën pjesë gjithsej 111 fëmijë (58 vajza dhe 53 djem).

Përdorimi i shkollës si arenë për angazhimin lokal: Bashkia e Goteborgut (rreth 591 000 banorë). Në zonën e Lundby-t (46 000 banorë), bashkia e Goteborgut u angazhua me fëmijët, të rinjtë e të rriturit për të vendosur se cilat aktivitete do të zbatonte në zonën përreth njëres prej shkollave (2020). Angazhimi u organizua përmes procesit të buxhetimit me pjesëmarrje, që u quajt, “Ideja jote”. Nisma u mbështet te bashkëpunimi unik midis bashkisë, shkollës lokale dhe kompanive (pronarëve) të strehimit. Për procesin “Ideja jote” u dha një buxhet prej 15 000 eurosh, që do të përdorej për një sërë aktivitete, secili prej të cilëve do të kushtonte maksimumi 3 500 euro. Shkolla lokale luajti rol themelor si arena e angazhimit, qoftë duke qenë në qendër të aktiviteteve buxhetuese, ashtu edhe duke qenë partnere aktive përgjatë procesit. Rreth 80 propozime sollën si rezultat shtatë ide pas votimit, përfshirë ‘parkour-in’¹ (disiplinë sportive e atletikës), shkollën e notit, klasat e gatimit, shtëpinë e fantazmave/horrorit, shëtitje me kuaj, lojëra nate dhe fjetja jashtë shtëpie. Propozimet fituese u zbatuan në vitin 2021. Nisma “Ideja jote” u përmend në vend nderi nga Observatori Ndërkombëtar për Demokracinë Pjesëmarrëse (ONDP), që jep çmimin “Praktika më e mirë në pjesëmarrjen qytetare” për të nderuar politikat publike të zbatuara nga njësitë e pushtetit vendor.

Shembujt e mësipërm i referohen buxhetimit me pjesëmarrje në shkolla përmes ndërveprimit të bashkive me nxënësit dhe studentët. Mundësia e nxënësve dhe studentëve **për të marrë pjesë në planifikimin e buxhetit të shkollës** është diçka e përhapur, por ndikimi i nxënësve dhe i studentëve është zakonisht i kufizuar te blerjet e vogla. Një shembull nga shkolla “Neptuni” në bashkinë Malmö është se nxënësit patën mundësi të propozonin pajisje sportive shtesë për oborrin e shkollës. Propozimet u kanalizuan nga këshilli i klasës te këshilli i nxënësve dhe sollën si rezultat blerjen e koshave të rinj të basketbollit. Po kështu, është zakon që **të bëhet një buxhet klase për një projekt të përbashkët** dhe të mbledhen fonde për këtë, si, për shembull, për një udhëtim me shkollën, mund të bëhet përmes pjekjes së ëmbëlsirave, shpërndarjes së gazetave, shitjes së biletave të lotarisë etj.

¹ Parkour është një disiplinë apo sport i stërvitjes atletike në të cilën praktikantët (të quajtur gjurmues) përpiqen të shkojnë nga një pikë në tjetrën në mënyrën më të shpejtë dhe më efikase të mundshme, pa u ndihmuar nga pajisje dhe shpesh kryejnë veprime akrobatike.

4.4 Të mësosh rreth demokracisë në nivel kombëtar përmes aktiviteteve të bazuara në përvojë

4.4.1 Zgjedhjet në shkollë

Zgjedhjet në shkollë janë zgjedhje të simuluar nga studentët që zhvillohen bashkë me zgjedhjet kombëtare. Zgjedhjet në shkollë synojnë t'i ndihmojnë studentët të kuptojnë sesi funksionojnë zgjedhjet dhe pse është e rëndësishme të votohet, si dhe ofrojnë mundësinë për të diskutuar mbi sistemin demokratik dhe mundësitë që kanë për të ndikuar në komunitetin e tyre. Në Suedi, zgjedhjet në shkollë janë organizuar që nga fundi i viteve '60 dhe që prej vitit 1998, bashkërendohen në nivel kombëtar. Zgjedhjet ofrojnë mundësinë për të diskutuar politikën dhe demokracinë në shkollë. Përmes procesit, studentët inkurajohen të formojnë opinionet e tyre politike rreth procesit demokratik. Është një mjet për t'iu mësuar studentëve rreth zgjedhjeve dhe për t'i përgatitur ata për pjesëmarrjen demokratike.

Zgjedhjet në shkollë përqendrohen kryesisht te klasat 7-9 dhe te shkolla e mesme. Në proces angazhohen një sërë agjencish dhe organizatash. Në nivel kombëtar, Agjencia e Rinisë dhe Shoqërisë Civile është përgjegjëse për përgatitjen dhe mbështetjen e zgjedhjeve në shkollë, në bashkërendim me Autoritetin suedez të Zgjedhjeve dhe Agjencinë Kombëtare suedeze të Arsimit.

Në nivel shkolle, zgjedhjet organizohen nga studentët dhe personeli i shkollës së bashku, shpesh, me përfshirjen e unioneve studentore ose këshillave të studentëve. Procesi përfshin procedurat standarde të zgjedhjeve, duke përdorur të njëjtat fletë votimi si të rriturit, kontrolltet, regjistrin e votuesve, kutitë e votimit dhe numëruesit e votave. Zgjedhjet në shkollë organizohen shpesh të lidhura me ditën e zgjedhjeve kombëtare në Suedi, po nuk kufizohen domosdoshmërisht vetëm te aktivitetet për një ditë. Shumë shkolla organizojnë edhe debate, ditë tematike apo vizita studimore lidhur me zgjedhjet. Shkollat mund të ftojnë edhe parti politike, që studentët të mund të mësojnë se çfarë përfaqësojnë parti të ndryshme. Megjithatë, këto vizita duhen organizuar në përputhje me rregullat përkatëse të Aktit për Arsimin.

Shkollat nuk e kanë të detyrueshme organizimin e zgjedhjeve. Ata që janë të interesuar mund të aplikojnë në Agjencinë e Rinisë dhe Shoqërisë Civile, për të marrë një paketë fillestare informacioni për mënyrën si të përgatitin dhe si të zhvillojnë një proces zgjedhjesh. Disa prej informacioneve janë të vlefshme për t'u shkarkuar edhe në internet. Paketa fillestare përfshin udhëzime, një listë me zëra dhe përshkrimin e roleve dhe përgjegjësi për ata që ngarkohen me organizimin dhe për çfarë duhet të mendojnë përpara, gjatë dhe pas zgjedhjeve. Sipas Agjencisë së Rinisë dhe Shoqërisë Civile, zgjedhjet e suksesshme në shkollë kërkojnë shpesh bashkëpunim midis personelit të shkollës dhe studentëve dhe, si rezultat, agjencia ka përgatitur materiale mbështetëse dhe ka sqaruar rolet e ndryshme me hollësi për të lehtësuar procesin.

Rezultatet e zgjedhjeve paraqiten në nivel shkolle, gjithashtu ato mblidhen dhe paraqiten edhe në nivel kombëtar nga Agjencia e Rinisë dhe Shoqërisë Civile. Sa i takon kohës, zgjedhjet në shkollë mbahen në javët përpara ditës kombëtare të zgjedhjeve, por rezultatet e përmbledhura të zgjedhjeve në shkollë nuk paraqiten deri pas ditës së zgjedhjeve kombëtare.

Në Suedi, zgjedhjet mbahen çdo katër vjet, në shtator. Zgjedhjet për parlamentin kombëtar dhe për Asamblatë Bashkiake dhe Rajonale mbahen në të njëjtën ditë. Në vitin 2022, zgjedhjet e përgjithshme u mbajtën më 11 shtator. Në javët që i paraprinë ditës së zgjedhjeve, më shumë se 500 000 nxënës dhe studentë morën pjesë në zgjedhjet në shkollë, gjithsej në 1454 shkollë (913 për nxënësit e klasave 7-9 dhe 510 shkollë të mesme). (Agjencia suedeze e Rinisë dhe Shoqërisë Civile).

Si mjet për të ndihmuar mësuesit të përgatiten për zgjedhjet në shkollë, Agjencia e Rinisë dhe Shoqërisë Civile ka hartuar materialin pedagogjik mbështetës, "Të flasësh për politikën", për t'ua bërë më të lehtë shkollave të punojnë sistematikisht dhe cilësisht me ligjërimin politik (shih më poshtë). Një ushtrim i përgjithshëm në lëndën e qytetarisë është organizimi i debateve, në mënyrë që nxënësit të mësojnë sesi të argumentojnë lidhur me një ndërhyrje të caktuar nga këndvështrime të ndryshme ideologjike dhe politike.

4.4.2 Të nxënit përmes përvojës dhe vizitat në Parlamentin suedez

Mijëra njerëz vizitojnë çdo vit Parlamentin suedez. Parlamenti është i hapur për vizitorët që duan të dëgjojnë seancat dhe debatet parlamentare, të cilët marrin pjesë në vizita turistike ose studimore. Mësuesit që punojnë në shkollat fillore, klasa 7-9 dhe në arsimin e mesëm të lartë janë të mirëpritur të sjellin nxënësit/studentët e tyre për një vizitë pedagogjike në parlament. Nxënësit e klasave 7-9 mund të përjetojnë si është të jesh anëtar i parlamentit për disa orë në Punishten e Demokracisë dhe studentët e shkollave të mesme të larta mund të zhvillojnë një vizitë studimore si pjesë e lëndës së tyre të qytetarisë. Po kështu, shkollat mund të rezervojnë vizita studimore (prej një ore) për nxënësit e klasës së 7-të e lart.

Punishtja e Demokracisë (klasa 7-9) është një lojë që bazohet në pedagogji dhe të nxënit përmes përvojës. Për një ditë, studentët marrin rolin e anëtarëve të parlamentit. Me mbështetjen e një tablete elektronike ata mbledhin informacione, negociojnë me njëri-tjetrin dhe marrin vendime për të përmbushur misionin e tyre si përfaqësues të zgjedhur. Të gjitha klasat nga e shtata deri në të nëntën ose nivelet e arsimit bazë për të rritur janë të mirëpritur të rezervojnë një vizitë në Punishten e Demokracisë.

Bazuar në përvojë, ndërvepruese – lidhet me kurrikulën shkollore dhe plotëson atë çka bëhet në klasë. Vlerësohet nga mësuesit dhe studentët dhe përjetohet nga mësuesit si mënyrë pozitive për t'u angazhuar, si dhe entuziazmon edhe ata studentë që, zakonisht, nuk kanë aq interes për politikën dhe çështjet sociale.

Vizita zgjat 1 orë e 45 minuta. Të paktën një mësues duhet të shoqërojë grupin gjatë vizitës. Klasa punon për një çështje tematike fiktive, ndahet në pesë parti të ndryshme dhe praktikohet duke mbajtur qëndrime, duke diskutuar dhe negociuar dhe duke marrë vendime. Klasat që vijnë në Punishten e Demokracisë mund të rezervojnë edhe një vizitë 30-minutëshe në Dhomën e Parlamentit që ka lidhje me qëllimin e ardhjes së tyre, duke u përqendruar te puna e Anëtarëve të Dhomës së Parlamentit. Përpara se të vizitojnë Punishten e Demokracisë, mësuesit rekomandohen të lexojnë udhëzuesin e mësuesit për t'u përgatitur për vizitën. Udhëzuesi përfshin edhe këshilla për detyrat me të cilat duhet të punojë klasa gjatë mësimit, pas vizitës.

Vizita studimore për studentët (shkolla e mesme): Klasat në shkollën e mesme kanë mundësi të zhvillojnë vizita studimore në Parlament. Mësuesit mund të rezervojnë një vizitë, për t'iu dhënë mundësi studentëve të tyre të thellojnë njohuritë rreth rolit të Parlamentit suedez. Vizita (1 orë e 30 minuta) nis me një prezantim të përgjithshëm të Parlamentit, ndjekur nga ushtrime të nxëni mes përvojës në ndërtesën e Parlamentit, të cilat përqendrohen në një nga këto dy tema: procesi ligjvënës (si bëhen ligjet) ose Parlamenti dhe Bashkimi Evropian (roli i Parlamentit në raport me BE-në). Gjatë vizitës, studentët informohen rreth secilës prej temave përkatëse dhe nxiten të mësojnë më shumë përmes ushtrimeve që mbështeten te të nxënit përmes përvojës.

Lidhur me vizitën studimore, klasat mund të takohen edhe me Anëtarë të Parlamentit për t'iu drejtuar pyetje. Këto vizita duhen rezervuar paraprakisht. Përpara sesa klasa të vizitojë Riksdag-un, mësuesit rekomandohet të lexojnë udhëzuesin e mësuesit, që përfshin sugjerime si të përgatitesh për vizitën, si dhe si të veprosh në vijim të saj. Klasat që kanë rezervuar një vizitë studimore mund të aplikojnë për grant udhëtimi nga Parlamenti suedez. Qëllimi i grantit është t'iu japë më shumë shkollave që iu duhet të bëjnë një udhëtim të gjatë e të kushtueshëm për në Stokholm mundësinë për të vizituar Parlamentin.

4.5 "Çmimet për mësuesin më të mirë" angazhojnë nxënësit dhe studentët

Që prej vitit 2016, në Suedi zhvillohet Mbrëmja e përvitshme ceremoniale për Mësuesit. Mbrëmja mbahet çdo vjeshtë dhe mbështetet në një nismë private dhe në filozofinë e nxjerrjes në pah të mësuesve të mirë si modele, në shenjë vlerësimi dhe për të motivuar një pedagogji edhe më të mirë në klasë. Ideja e Mbrëmjes për Mësuesit erdhi nga Znj. Beata Kull, themeluesja, e cila ndien shumë mirënjohje për ndihmën e madhe që dikur iu dha nga mësuesit gjatë viteve të saj të shkollës. Ajo pa se kishte mungesë vëmendjeje dhe vlerësimi për mësuesit dhe donte të theksonte rëndësinë e tyre duke vlerësuar me çmim ata mësues që mund të frymëzojnë të tjerët si modele. Ideja e saj ishte përhapja e shembujve frymëzues përmes aktiviteteve të ndryshme gjatë vitit. "Dija dhe mësuesit janë super", thotë Beata, e cila ka disleksë dhe, kur ishte fëmijë dhe rrinte e ndrojtur në klasë, u mbështet dhe u inkurajua nga mësues të mirë.

Mbrëmja për Mësuesit iu jep një mundësi të papërsëritshme nxënësve dhe studentëve të tregojnë dhe të shprehin atë çka vlerësojnë te mësuesit e tyre. Ceremonia nuk është pjesë e aktiviteteve shkollore apo e edukimit për demokraci, por një shembull i angazhimit, pjesëmarrjes dhe ndikimit të nxënësve dhe studentëve, që është çdo votë që ka vlerë për rezultatin. Çdo pranverë, nxënësit dhe studentët propozojnë mësuesit të cilët, sipas tyre, bëjnë dallimin e madh. Nga 700 propozime në vitin 2016, tani, në proces angazhohen rreth 45 000 nxënës/studentë. Një juri me bazë të gjerë analizon propozimet dhe sigurohet që fitues të jenë mësuesit me kredenciale të mira, të cilët kualifikohen për çmimin. Puna lidhur me Ceremoninë bëhet me kontributet vullnetare të bordit, bordit këshillimor dhe të tjerëve.

Ka disa çmime si "Mësuesi më i mirë" në kategori të ndryshme: ka një çmim për bashkitë (290) dhe për rajonet (21) dhe arsimin e detyrueshëm (klasa 4-6) dhe (klasa 7-9) dhe për arsimin e mesëm të lartë. Po ashtu ka një çmim për "Entuziastin e vitit". Mbrëmja ceremoniale është transmetuar në televizion dhe ka angazhuar një sërë personazhesh të njohur, përfshi anëtarë të familjes mbretërore suedeze.

4.6 #Tëpremtetpërtëardhmen – Greva e shkollës për klimën

Qëndrueshmëria, çështjet mjedisore dhe ndryshimi i klimës kanë hyrë në agjendën e qytetarisë demokratike të të rinjve në Suedi. "Të premtet për të ardhmen" është një lëvizje globale rinore që nisi në gusht 2018, në Suedi, kur 15-vjeçarja, Greta Thunberg, disa javë përpara zgjedhjeve suedeze të vjeshtës, u ul jashtë ndërtesës së Parlamentit në Stokholm për të protestuar dhe për të rritur ndërgjegjësimin lidhur me krizën e klimës. Ajo ishte lodhur nga indiferenca e shoqërisë për ta parë krizën e klimës si një krizë. Shpejt, të tjerë aktivistë të rinj u bashkuan me Greta Thunberg-un duke u ulur përpara Parlamentit suedez çdo ditë shkolle, për tri javë, në shenjë proteste kundër mungesës së reagimit e veprimit ndaj krizës së klimës. Pas postimeve në *Instagram*, *Twitter* dhe transmetimit të grevës nga kanalet e informimit, lëvizja u përhap menjëherë, duke shënuar fillimin e një greve globale të shkollave për klimën. Pas zgjedhjeve të shtatorit 2018, Greta vendosi ta vazhdonte grevën e saj çdo të premte, deri kur Suedia u bë palë e *Marrëveshjes së Parisit*, që u nënshkrua në vitin 2015. #Tëpremtetpërtëardhmen ka angazhuar nxënës dhe studentë nga më shumë se 100 vende në protesta që u kërkojnë politikanëve të marrin vendime për të ruajtur rritjen e temperaturës globale poshtë 1.5 ° C, në përputhje me *Marrëveshjen e Parisit*, për të garantuar drejtësi për klimën dhe për të dëgjuar/ndjekur shkencën më të mirë të unifikuar në dispozicion. Thirrja për veprim ka nxitur një zgjim ndërkombëtar dhe, bashkë me grupe të tjera në mbarë botën, #Tëpremtetpërtëardhmen është pjesë e një vale të re ndryshimi, që frymëzon miliona njerëz të ndërmarrin veprime dhe të ushtrojnë trysni morale mbi politikëbërësit, për të kufizuar ngrohjen globale.

Nisma në fjalë është pasuar nga greva globale me pjesëmarrjen e 1,4-1,8 milionë njerëzve. Në maj 2019, në Grevën Globale për të Ardhmen, më shumë se 4 000 të rinj morën pjesë në manifestime të përbashkëta në qendër të Stokholmit dhe rreth 100 protesta u organizuan në mbarë Suedinë. Nuk ka pasur një qasje të përbashkët nga shkollat ndaj këtyre protestave. Në periudhën më intensive, disa shkolla i lanë hapur nxënësit të lirë të merrnin pjesë në protesta, ndërkohë që të tjera nuk e bënë këtë në mënyrë të shprehur, megjithatë, të tjera organizuan manifestime brenda shkollave. Nuk ka dyshim se lëvizja globale është një shembull i qartë i mundësisë që zërat lidhur me çështjet e rëndësishme të dëgjohen paqësisht. Lëvizja është ende aktive me veprimtari të reja, përfshi protestat kombëtare të premtëve përpara zgjedhjeve suedeze, që mbahen në shtator 2022.

4.7 Të mësosh demokracinë – burimet, orientimi, praktikat

Ekziston një gamë materialesh didaktike për mësuesit e angazhuar në mësimdhënien rreth/përmes demokracisë. Përveç materialeve mësimore të prodhuara nga botues të ndryshëm dhe prodhues të materialeve mësimore, mësuesit mund të shfrytëzojnë nga interneti edhe një mori materialesh pedagogjike të prodhuara nga autoritetet qeveritare dhe entet me financim publik. Më poshtë, janë disa shembuj materialesh mbështetëse dhe orientuese, që mund të përdoren nga mësuesit, si edhe disa shembuj praktikash.

4.7.1 “Të flasësh për politikën” dhe “Të flasësh për demokracinë”

Agjencia e Rinisë dhe Shoqërisë Civile ka përgatitur disa burime për mësuesit dhe nxënësit/studentët lidhur me misionin e demokracisë në shkollë. **“Të flasësh për politikën”** është një material metodologjik mbi ligjërimin demokratik në shkollë. Materiali iu drejtohet kryesisht nxënësve të arsimit fillor, klasave 7-9 dhe atyre të arsimit të mesëm. Qëllimi i tij është që të ndihmojë shkollat të punojnë sistematikisht dhe cilësisht me ligjërimin politik. Materiali është i dobishëm për të mësuar rreth demokracisë dhe për t’u përgatitur për zgjedhjet në shkollë. Ai mund t’iu ofrojë gjithashtu mbështetje mësuesve, që punojnë në shkollat ku ftohen për vizitë përfaqësues të partive politike. Ky material metodologjik trajton tema dhe çështje që mësuesit mund t’i diskutojnë me kolegët dhe njëherësh i nxit ata të punojnë së bashku si trupë mësimore. Të nxënit kolektiv konsiderohet një faktor i rëndësishëm për suksesin. Ky material ka për qëllim që të shërbejë si burim metodologjik jo vetëm për ata që japin lëndën e qytetarisë, por për të gjithë mësuesit. Ai është konceptuar të stimulojë të gjithë shkollën për të krijuar një hapësirë të ligjëritimit politik. <https://www.mucf.se/en/publications/talking-politics>

“Të flasësh për demokracinë” është një material mësimor me ushtrime, që lidhet me objektivat dhe kërkesat e kurrikulës dhe u drejtohet shkollave të veçanta dhe shkollave profesionale të arsimit të mesëm. Synimi është që mësuesit ose drejtuesit e shkollës të kenë mundësi ta përdorin materialin për të krijuar interes dhe përkushtim në punën me vlerat e demokracisë dhe të drejtat e njeriut. Materiali përbëhet nga disa pjesë, si manuali për drejtuesit e shkollave, që tregon sesi mund të funksionojë dhe të zbatohet në mënyrë të strukturuar misioni i shkollës për demokraci. Kështu, për shembull, materiali përfshin informacione rreth misionit për demokraci të shkollës dhe *Konventës për të Drejtat e Fëmijës*, si dhe jep mënyrën se si punohet me çështjet e debatueshme dhe si reagohet ndaj mendimeve që bien ndesh me vlerat e shkollës. Përveç kësaj, materiali përfshin këshilla për të punuar me demokracinë në shkollë, përpara, gjatë dhe pas zgjedhjeve të shkollës. Materialin e ka porositur *Agjencia e Rinisë dhe Shoqërisë Civile*.

“Manuali i demokracisë – nga angazhimi te ndikimi”, është pjesë e paketës për demokracinë të Agjencisë për shkollat. Manuali i demokracisë mund të lexohet nga fillimi deri në fund ose të përdoret si enciklopedi. Ai përmban si shembuj, ashtu edhe pyetje që i japin mbështetje lexuesit. Manuali mund të përdoret si material pune për mësimdhënie ose si material mbështetës për të organizuar një kohë pushimi cilësor me të rinjtë. Çështjet e përfshira lidhen me të drejtat e qytetarit për t’u angazhuar në demokraci, për të shprehur mendimet e veta dhe për t’u organizuar. Manuali është gjithashtu një mjet për të stimuluar të rinjtë të angazhohen, duke iu shpjeguar atyre se kanë një rol të rëndësishëm dhe mundësitë për të sjellë ndryshim.

4.7.2 Mësimdhënia dhe mësimnxënia rreth demokracisë duke përdorur filma të shkurtër dhe diskutime

Kompania Suedeze e Transmetimit Edukativ (Utbildningsradion/UR), e themeluar në vitin 1978, është korporatë shërbimi publik, që u shërben nevojave të publikut të përgjithshëm suedez përmes një programi edukativ në radio, televizion dhe podkaste. Në kuadër të detyrave të saj dhe mbështetjes për mësuesit e nxënësit, në vitin 2022, *Kompania e Transmetimit Edukativ* hartoi dy paketa edukative rreth demokracisë. Materiali është në përputhje me kurrikulën kombëtare dhe është rishikuar nga mësuesit e lëndës së qytetarisë.

Mësimdhënia dhe mësimnxënia rreth demokracisë, klasa 4-6, një paketë që përmban 5 filma të shkurtër mësimorë (nga 14 minuta secili) të cilët përqendrohen te: 1) zgjedhjet dhe votimi; 2) kushtetuta; 3) partitë politike; 4) procesi i demokratizimit në Suedi dhe 5) shembuj të rinjve të angazhuar në zhvillimet në shoqëri.

Mësimdhënia dhe mësimnxënia rreth demokracisë, klasa 7-9, paketë që përfshin filma të shkurtër, detyra për nxënësit, shembuj të çështjeve për diskutim, video udhëzuese dhe orientime pedagogjike. Çdo pjesë është e pavarur dhe mësuesit mund të zgjedhin pjesët dhe detyrat e përshtatshme për studentët e tyre. Më poshtë po japim katër tema:

- Interesi dhe angazhimi ndaj demokracisë – hyrja që synon t'i bëjë studentët ta ndjejnë se ia vlen ta mbrosh dhe të marrësh pjesë aktive në demokraci.
- Elementet bazë të sistemit politik suedez, duke u përqendruar te konceptet kryesore dhe parimet e demokracisë.
- Si lidhen ideologjitë dhe partitë.
- Trajtimi i çështjeve të vështira dhe mendimeve të debatueshme (duke përfshirë udhëzuesin e bashkëbisedimit).

4.7.3 Kritika e burimeve, bashkëbisedimet demokratike dhe propaganda

Kritika e burimeve dhe vlerësimi kritik i burimeve përbëjnë aftësi të rëndësishme në epokën tonë digjitale, me flukse të jashtëzakonshme informacioni, të cilat e vështirësojnë, ndonjëherë, dallimin e së vërtetës nga gënjeshtra dhe identifikimin e burimeve të besueshme.

Materialet orientuese për mësuesit në lidhje me kritikën e burimeve dhe vlerësimin kritik të burimeve – *Agjencia Suedeze e Arsimit* thekson se është e rëndësishme, që nxënësit dhe studentët të zhvillojnë aftësi për kritikën e burimeve dhe se kompetenca digjitale, duke përfshirë vlerësimin kritik të burimeve, është kompetencë themelore demokratike. Agjencia ka hartuar materiale udhëzuese për mësuesit, ku bëjnë pjesë një podcast, me një ekspert, lidhur me kritikën e burimeve, një listë kontrolli për kritikën e burimeve klasike dhe medias sociale, shembuj pyetjesh për diskutim, këshilla nga mësues të tjerë, bazuar në përvojën e tyre me kritikën e burimeve, këshilla për burime të dobishme (adresa të faqeve të internetit, instrumente dhe organizata).

Një tjetër paketë për mësuesit është hartuar nga *Forumi "Historia Jeton"/Living History Forum*. *Kritika e burimeve, përdorimi i historisë dhe racizmi*, është material ndërveprues për përdorim në klasë, me të cilin studentët zhvillojnë aftësitë e tyre kritike për burimet dhe përdorimin e historisë, çka është e rëndësishme për menaxhimin e llojeve të ndryshme të informacionit, të mendimeve dhe vlerave që ekzistojnë në demokraci. Materiale të tjera të ngjashme mësimore nga *Forumi "Historia Jeton"*:

Bashkëbisedimet demokratike, një paketë mësimore rreth mënyrës sesi duhet të flasim me njëri-tjetrin, për t'i krijuar hapësirë mendimit të ndryshëm në demokraci. Në këtë material, për përdorim në klasë, studentët nxiten të formojnë mendime rreth çështjeve komplekse që lidhen me demokracinë dhe, në të njëjtën kohë, të praktikojnë aftësitë e të folurit.

Propaganda – rreziku i ndikimit, është material digjital për përdorim në klasë, për arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë. Përmes studimit të mekanizmave të propagandës, si dhe vlerësimit të ndjeshmërisë që kemi ne si njerëz ndaj ndikimeve, mund të trajtojmë më mirë mesazhet e manipuluar, që ndeshim në jetët tona të përditshme. Materiali përbëhet nga katër pjesë të veçanta, të cilat trajtojnë këndvështrime konkrete të propagandës dhe ndikimit, duke u bazuar në shembuj historikë.

4.7.4 Përdorimi i "Lajmeve" si pjesë e edukimit qytetar dhe të demokracisë

Përdorimi i lajmeve në arsim është një prej mënyrave për të ndihmuar nxënësit të reflektojnë e të kuptojnë çfarë ndodh në botë. Raportimi i lajmeve mund të jetë i dobishëm edhe për zhvillimin e kompetencave demokratike. Mësuesit mund të përdorin lloje të ndryshme të raportimit të lajmit dhe mënyra të ndryshme. Megjithatë, lajmet mund të jenë edhe të vështira për t'u kuptuar nga fëmijët. Për të ndihmuar në këtë drejtim, *Kompania e Shërbimit Televiziv Publik* në Suedi (Sverige Television/SVT) transmeton një program lajmesh për fëmijët që prej vitit 1972 që titullohej 'Barnjournalen'. Që nga viti 1993, programi titullohet 'Lilla Aktuellt' (Lajme për fëmijë) dhe transmetohet çdo ditë të javës në mbrëmje. Ky program, që iu drejtohet fëmijëve të grupmoshës 9-12 vjeçe, që nga viti 1993, transmeton lajme në mënyrë më të thjeshtë, duke përfshirë intervista me politikanë dhe përfaqësues në funksione kryesore, si nga policia etj.

Gjithashtu, çdo të premtë ka një program të veçantë që iu drejtohet shkollave ('Lilla Aktuellt Skola'), i cili transmeton lajmet kryesore të javës për 20 minuta. Programi synon kryesisht vitin 4-6 dhe zhvillohet në bashkëpunim me *Kompaninë e Transmetimit Edukativ* të Suedisë. Në varësi të çështjeve që transmetohen në lajme gjatë javës, ftohen përfaqësues nga autoritetet dhe organizatat, për ta shpjeguar çështjen në mënyrë të thjeshtë, si: drejtuesi i autoritetit policor, ministri i arsimit etj. Mësuesit, që dëshirojnë ta përdorin këtë program në mësimdhënie, mund të gjejnë shembuj pyetjesh për diskutim në një buletin javor. Më poshtë paraqesim dy shembuj sesi përdoret programi javor në mësimdhënie.

Mësimdhënia e lëndës së Qytetarisë, klasa 1-3. Në një shkollë në Norrtälje, mësuesja shpjegon se ata ndjekin programin e lajmeve çdo javë dhe, më pas, diskutojnë çfarë kanë parë dhe çfarë mendojnë për të. Gjatë viteve, ajo ka provuar mënyra të ndryshme për të punuar me nxënësit, kur vjen fjala për mësimnxënien, diskutimin dhe reflektimin mbi përmbytjen e programit javor. Shembujt inkurajojnë fëmijët që të shkruajnë rreth një lajmi dhe të ndajnë mendimet e tyre lidhur me të.

Mësimdhënia e lëndës së Qytetarisë, klasa 4-6. Në një shkollë në Uddevalla, një mësues shprehet se ata shohin raportimin javor të lajmeve çdo javë, si pjesë e orës mësimore të Qytetarisë. Sipas mësuesit, programi është një burim i dobishëm për të kuptuar shoqërinë dhe atë që ndodh në botë dhe ka një lidhje të qartë me disa aspekte të kurrikulës, si: mësimi rreth vlerave demokratike dhe proceseve të vendimmarrjes dhe të drejtave të njeriut, ku përfshihet roli i medias dhe kritika e burimeve. Programi përdoret si pikënisje për diskutime, analiza, si dhe për të kuptuar pasojat e ngjarjeve të ndryshme.

4.8 Demokracia dhe krimet kundër njerëzimit

4.8.1 Materiale pune për demokracinë, tolerancën dhe të drejtat e njeriut

Forumi "Historia Jeton" në Suedi është një agjenci publike e cila punon për fuqizimin e nismave që garantojnë demokracinë, si dhe për të promovuar demokracinë, tolerancën dhe të drejtat e njeriut, duke përdorur si pikënisje njohuritë rreth Holokaustit dhe krimeve të tjera kundër njerëzimit. Forumi "Historia Jeton" ka hartuar materiale pune mbi demokracinë për përdorim në klasë, të cilat trajtojnë demokracinë, tolerancën dhe të drejtat e njeriut. Materiali është falas, gjendet në internet dhe përfshin manualët e mësuesve, materialet trajnuese dhe prezantimet pamore. Ai është hartuar për të nxitur studentët të diskutojnë dhe të reflektojnë, duke iu drejtuar kryesisht klasës së 9-të dhe shkollave të mesme. Materiali është rezultat i planit të veprimit të qeverisë suedeze për të ruajtur demokracinë nga ekstremizmi që nxit dhunë.

Përmes ngjarjeve historike dhe historive personale të këtij materiali, studentët nxiten të diskutojnë dhe të reflektojnë mbi çështjet sociale aktuale. Ai përmban 22 materiale pune për t'u përdorur në klasë, që trajtojnë tri tema: demokracinë, tolerancën, të drejtat e njeriut. Temat dhe çështjet e trajtuara janë ndërvepruese dhe u japin mundësi mësuesve të

zgjedin ushtrimet që përshtaten me grupin e studentëve dhe situatën mësimore. Po ashtu, mësuesit janë të lirë të krijojnë një strukturë që i përshtatet kontekstit dhe mënyrës së tyre të mësimdhënies. Një material pune kërkon rreth një orë e gjysmë për t'u përfunduar, prandaj ai mund të përdoret pjesërisht ose mund të shfrytëzohen vetëm ushtrime të përzgjedhura.

Paketa e demokracisë është hartuar për të punuar në nivel të përgjithshëm, si dhe për mësimdhënien e një lënde (që orientohet kryesisht drejt qytetarisë, historisë, fesë dhe gjuhës suedeze). Forumi "Historia Jeton" zhvillon kurse trajnimi për mësuesit dhe materiali është falas. Qëllimi është që mësuesit ta përdorin materialin edukativ si pjesë përbërëse të arsimit të rregullt, jo si një kurs të shkurtër mbi demokracinë. Materiali nxit studentët të reflektojnë dhe të formojnë mendime të pavarura, të sfidojnë vlerat dhe idetë e tyre dhe të shmangin përgjigjet e thjeshtëzuara. Studentët do të praktikojnë gjithashtu, jo vetëm aftësinë për të shprehur mendimet dhe opinionet e tyre, por dhe për të dëgjuar të tjerët.

Çdo material pune përmban ushtrime të ndryshme, disa janë me tekste, disa me foto, disa të tjera me filma dhe një numër i madh vjen nga paragjykimet e vetë studentëve. Materialet e punës përmbajnë pjesë të barabarta ushtrimesh konkrete dhe përputhen me kurrikulën suedeze në lidhje me detyrën e shkollës për të promovuar respektimin e të drejtave të njeriut dhe vlerat e normat themelore demokratike. Materiali shpërndahet përmes kurseve trajnuese për mësuesit, faqes së internetit të Forumit "Historia Jeton", konferencave dhe takimeve me politikanë dhe drejtues vendorë.

Një nga mësueset e një shkolle të mesme në Malmö, e cila ka përdorur një sërë materialesh pune gjatë mësimdhënies së rregullt, beson se materiali i Forumit "Historia Jeton" i ka ardhur shumë në ndihmë. *"Në varësi të njohurive të mëparshme të studentëve, mund të gjej e të zgjedh nga materiale të ndryshme pune, që t'i përshtaten qëllimit tim. Jam mirënjohëse që nuk më duhet të shpik rrotën sa herë më duhet një ushtrim i ri. Është shumë më e lehtë të përdor një material që ekziston",* thotë ajo dhe shton se i pëlqen që ushtrimet janë praktike dhe ndërvepruese.

<https://www.levandehistoria.se/english/educating-youth/mission-democracy>

4.8.2 Takimi me të mbijetuarit e Holokaustit

Në Suedi jetojnë disa të mbijetuar të Holokaustit, të cilët janë angazhuar aktivisht për të ndarë në mënyra të ndryshme përvojat e tyre, duke përfshirë edhe vizitat në shkolla. Disa prej tyre kanë vizituar vazhdimisht shkollat gjatë jetës, madje disa shkolla kanë organizuar vizita dhe leksione rregullisht. Por, nuk kanë pasur mundësi të gjitha shkollat të ftojnë dikë që ka përvojë personale nga Holokausti, ndërkohë që dhe ata pak që janë ende në jetë, tashmë po plaken. Megjithatë, ka ende disa persona që vazhdojnë të ndajnë përvojat e tyre të Luftës së Dytë Botërore, ndaj më poshtë po japim dy shembuj të viteve të fundit.

- **Prill 2017:** Leksion nga Mietek Groscher, 90 vjeç, i lindur në Poloni, i cili vizitoi një shkollë të mesme në Umeå. Groscher. Ai ka jetuar në Suedi që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore dhe ka mbajtur qindra leksione lidhur me përvojën e tij në geton e Varshavës dhe në nëntë kampe të ndryshme përqendrimi. Kur nisi pushtimi i Polonisë, ai ishte 12 vjeç. Në leksion u ftuan studentët, prindërit dhe motrat e vëllezërit e tyre.
- **Dhjetor 2021:** Tobias Raëet, 85 vjeç, mbajti një leksion për nxënësit e nëntë shkollave të mesme (klasa 7-9) në zonën e Stokholmit. Për 25 vjet, Raëet ka ndarë përvojat e tij nga getoja në Lodz dhe nga kampi i përqendrimit në Ravensbruck. Gjatë leksionit ai tregoi letra dhe foto nga Lufta e Dytë Botërore, por edhe nga vitet e tij të para në Stokholm, në fund të viteve '40. Leksioni u organizua nga *Fondacioni i Fshatit Global*, së bashku me *Institutin Raoul Éallenberg*.

4.8.3 Çmimi i Shkollave për Paqen – të mësosh për Holokaustin

Në vitin 2022, *Fondacioni Emerich*, bashkë me *Fredens Hus* (një organizatë jofitimprurëse për paqen dhe të drejtat e njeriut, që punon prej vitit 2006 në frymën e Dag Hammarskjöld, duke promovuar paqen, të drejtat e njeriut dhe mundësitë) prezantoi nismën *Çmimi i Shkollave për Paqen* (Skolornas Fredspris). Ky çmim është një mjet promovimi për të shtuar njohuritë, gjatë një viti akademik, të mësuesve dhe nxënësve/studentëve mbi Holokaustin përmes ecjes në hapat e të mbijetuarit të Holokaustit, Emerich Roth. Gjatë kësaj kohe, zhvillohen trajnime së bashku me *Fredens Hus* dhe *Fondacionin Emerich* me objektivin që të rinjtë të edukohen për të qenë reflektues dhe empatikë me njerëzit e tjerë dhe të bëhen qytetarë të përgjegjshëm të shoqërisë, si dhe t'i përcjellin brezave të ardhshëm mesazhin e të mbijetuarit të Holokaustit, Emerich Roth (i cili nuk jeton më) për një shoqëri më paqësore dhe demokratike.

Përmes procesit, shkolla trajton çështje të të drejtave të njeriut, të paqes, humanizmit, kurajës civile, jotolerancës dhe normave. Po ashtu, ka trajnim të mëtejshëm të personelit të shkollës për misionin demokratik. Një grupi të fokusuar në shkollë i jepet trajnim i thelluar dhe mundësia për kryerjen e një udhëtimi në një prej vendeve përkujtimore. Shkollat mund të vetëpropozohen për të marrë pjesë në këtë proces, përfshi dhënien e një kontributi financiar për udhëtimin.

4.9 Të nxënësve kolektiv, shkëmbimi dhe mësimdhënia ndërdisiplinore

4.9.1 Të nxënësve kolektiv – shembull i punës me çështje të debatueshme

Menaxhimi i çështjeve të debatueshme në kontekstin shkollor mund të jetë sfidues për shumë mësues. Këshilli i Evropës (KiE) ka nxjerrë udhëzime në formën e manualeve sesi të mësohen çështjet e debatueshme dhe si të menaxhohen kundërshtitë. Po ashtu, ka një Udhëzues të Praktikës së Mirë. Në vitin 2017, një shkollë e mesme në Stokholm u bë pjesë e procesit të pilotimit të manualit të KiE-s, "Të mësosh çështjet e debatueshme", që zhvillua në vendet nordike. Dy persona nga shkolla, një mësues dhe një person nga ekipi drejtues, u trajnuan për materialin. Arsyeja pse nisa të interesohesha për këtë ishte se e pashë të nevojshme, u shpreh një mësues. Si mësues, e gjeta veten në situata ku më duhej t'u përgjigjesha pohimeve të ndryshe që më dukeshin jo në përputhje me objektivat e kurrikulës ose që, ndonjëherë, mund të ishin fyese për të tjerët në klasë. Përveç kësaj, sot po vihen në diskutim gjëra që nuk ishin të tilla vetëm pak vjet më parë.

Në shkollë kishte një sistem ku i jepej kohë zhvillimit të aftësive njëherë në dy javë, të mërkurave. Në këtë kuadër u krijua grupi për çështjet e debatueshme, i cili mblidhej njëherë në muaj për 90 minuta. Ata që zgjedhën çështjet e debatueshme e bënë sepse ishin të interesuar për temën. Ata që nuk e zgjedhën këtë si zhvillim kompetence, sërish duhet të mësojnë përmes seminareve për çështjet e debatueshme gjatë një dite studimi.

Pjesëmarrësit në procesin e të nxënësve kolektiv u shprehën se për ta ishte e rëndësishme dhe me vlerë që të kishin kohë për biseda kolektive. "Çfarë është e debatueshme nuk është njësoj nga një person te tjetri dhe, si personel, ne duhet të flasim me njëri-tjetrin për të krijuar emërues të përbashkët dhe konsensus kolektiv", tha një prej mësuesve pjesëmarrës. Po kështu, mësuesit ranë dakord se puna mbi çështjet e debatueshme kishte forcuar mësimdhënien e tyre.

4.9.2 Platformat e shkëmbimit dhe të frymëzimit të mësuesve

Në Suedi ka disa prodhues të materialeve mësimore, përfshi materialet pedagogjike. Përveç kësaj, ekzistojnë edhe platforma ku mësuesit ndajnë përvoja të tyre në mënyra të ndryshme.

Banka e Shkollës (*Skolbanken*) – është një platformë të nxënësve, ku mësuesit nga e gjithë Suedia ndajnë përvoja dhe këshilla konkrete si frymëzim, përfshi planet pedagogjike dhe përmbledhjet e mësimëve, shembuj të pyetjeve për diskutim dhe dialog etj. Ka më shumë se mijëra shembuj dhe materiale, që shtohen në mënyrë konstante. Mësuesit janë të lirë t'i përdorin materialet siç janë ose t'ua përshtatin nevojave të tyre.

Materiale falas në shkollë (*Gratisiskolan.se*) është një platformë digjitale e që zotërohet dhe administrohet nga një kompani e përqendruar te ndihma për autoritetet dhe grupet e interesit për të ndikuar me nisma të ndryshme shoqërore përmes konkurseve, nismave informuese dhe materialeve mësimore. Ideja është të krijohet mundësia për t’iu ofruar mësuesve dhe personelit shkollor materiale dhe instrumente mësimore falas. Mes të tjerave, platforma ndan burime dhe mjete të hartuara nga autoritetet lidhur me edukimin demokratik.

Mësuesit në Malmö (*Pedagog Malmö*) – është një faqe interneti për shkëmbime dhe frymëzim nga mësuesit për mësuesit në bashkinë Malmö. Duke qenë se është në internet dhe hyrja është e lirë, mund të shihet edhe nga të tjerë. Ideja e kësaj faqeje interneti është të frymëzojë, duke ndarë postime nga blogje, artikuj, filma dhe informacione rreth kurseve, seminareve dhe leksioneve për mësuesit. Një sërë artikujsh përqendrohen ose kanë lidhje me misionin demokratik të shkollave.

4.9.3 Mësimi ndërdisiplinor rreth zhvillimit të qëndrueshëm

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 janë përfshirë në mënyra të ndryshme në arsimin suedez, edukimi mbi mjedisin dhe mësimi mbi zhvillimin e qëndrueshëm janë pjesë e kurrikulës, kursit dhe planeve të lëndës. Megjithatë, mësimi për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm nuk është lëndë më vete në arsimin e detyrueshëm ose të mesëm. Kështu, ideja është që këndvështrimet mjedisore dhe të qëndrueshmërisë, së bashku me ato historike, ndërkombëtare dhe etike duhet të përshkojnë të gjithë mësimdhënien, pavarësisht kursit apo lëndës. Dokumentet orientuese nuk kanë referenca të drejtpërdrejta ndaj Agjendës 2030. Nga ana tjetër, në rubrikat hyrëse të kurrikulës ka lidhje të qarta, si demokracia, barazia gjinore, sipërmarrja dhe zhvillimi i qëndrueshëm, të cilat janë thelbësore për Agjendën 2030.

Agjencia Kombëtare suedeze e Arsimit ofron rritjen e kompetencave për zhvillimin e qëndrueshëm në arsimin e detyrueshëm dhe të mesëm përmes portalit digjital të të nxënit. Qëllimi është të nxiten diskutimet didaktike sesi mund të organizohet mësimdhënia lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm. Portali përmban gjithashtu materiale për zhvillimin e kompetencave të drejtuesve të shkollave rreth udhëheqjes së ndryshimit, që mund të përdoren për organizimin e punës për zhvillimin e qëndrueshëm. Agjencia ka hartuar gjithashtu burime për t’u përdorur në mësimdhënie që lidhen me misionin e përgjithshëm të demokracisë. Modulet “Të nxënit mbi zhvillimin e qëndrueshëm” përmbajnë disa qasje të rëndësishme didaktike, që, sipas kërkimeve, kanë provuar se janë të suksesshme për të përfutur një ide të mirë rreth zhvillimit të qëndrueshëm. Sipas tyre, mësimdhënia duhet të karakterizohet nga: metoda demokratike pune, qasje kritike, bashkëpunime ndërkurrikulare, larmi të metodave pedagogjike, si dhe pjesëmarrje e ndikim nga studentët.

Të nxënit disiplinor kolektiv është diçka që inkurajohet. Modulet për zhvillimin e qëndrueshëm theksojnë, ofrojnë shembuj dhe konkretizojnë mënyrën sesi mund të përdoret e të zhvillohet mësimnxënia kolektive. Materiali tregon sesi të nxënit rreth zhvillimit të qëndrueshëm mund të jetë po ashtu një mjet për të praktikuar metodat e punës demokratike dhe për të forcuar kompetencat demokratike. Për shembull, duke inkurajuar pjesëmarrjen dhe ndikimin e studentëve dhe duke përdorur qasje kritike, reflektim mbi vlerat, këndvështrimet lokale e globale, si dhe bashkëpunimin ndërdisiplinor dhe një larmi metodash pedagogjike. Lidhur me temat ndërkurrikulare, mësuesit inkurajohen të diskutojnë sesi mund të kontribuojnë për ta zhvilluar mësimdhënien nga këndvështrimi i lëndëve të ndryshme.

4.10 Shoqëria civile, demokracia dhe rinia

Në Suedi ekzistojnë një sërë mekanizmash qeveritare në mbështetje të shoqërisë civile. Një shembull që lidhet me arsimin dhe rininë është shpërndarja e fondeve për organizatat dhe projektet përmes Agjencisë suedeze të Rinisë dhe Shoqërisë Civile. Disa prej këtyre granteve vjetore synojnë projekte që punojnë për të luftuar diskriminimin, racizmin dhe ekstremizmin ose për të promovuar barazinë, demokracinë dhe pjesëmarrjen. Grantet bazohen tek aplikimet nga organizatat e shoqërisë civile, disa prej të cilave përqendrohen shprehimisht te nxënësit dhe studentët në shkollë ose të rinjtë. Më poshtë janë dy shembuj projektesh që kanë marrë fonde nga Agjencia për Rininë dhe Shoqërinë Civile, ndjekur nga disa informacione rreth dy shoqatave, që përqendrohen te promovimi i vlerave demokratike te të rinjtë.

- **“Zëri im demokratik”** – një paketë me pesë podkaste, ku dy studentë në shkollë të mesme diskutojnë rreth demokracisë me një panel prej tre ekspertësh. Materiali është hartuar nga Shoqata “Norden”, e themeluar në vitin 1919, që është një organizatë jopolitike dhe jofetare, e përqendruar te përmirësimi i bashkëpunimit nordik në të gjitha nivelet, përfshi arsimin, si një prej fushave me interes të posaçëm. Të diskutosh rreth demokracisë është e rëndësishme, por mund të jetë e vështirë. Materiali, i cili është falas e mund të shkarkohet, ofron një mënyrë ndryshe dhe angazhuese të përcjelljes së njohurive rreth konceptit të demokracisë dhe të nisjes së bashkëbisedimit në klasë mbi vlerat dhe sfidat e demokracisë. Këndvështrimi është suedez, nordik dhe global. Në materialin mësimor bashkëlidhur ka një përshkrim të qëllimit, lidhje me planet e lëndëve dhe udhëzime praktike për mësimdhënien për çdo episod. Seria e podkasteve është hartuar në përputhje me përmbajtjen përkatëse të kurrikulës. Materiali për studentët përfshin hyrjen në rubrika dhe ushtrime, përfshi pyetjet për përgatitje në shtëpi, pyetjet për diskutime në shkollë dhe një detyrë të thelluar. Përpara prezantimit të paketës me podkaste dhe materiale mësimore/për studentët, ajo u pilotua në një shkollë të mesme, e cila e konsideroi shumë të dobishme për të mësuar rreth demokracisë, por edhe për të kuptuar rëndësinë e demokracisë dhe të pjesëmarrjes në proceset demokratike.
- **“Heronjtë e demokracisë”** – një paketë me 16 pjesë (episode), që mund të përdoret nga mësuesit për të diskutuar rreth demokracisë me nxënësit (klasat 1-3 e sipër). Paketa përmban 16 filma të shkurtër vizatimorë mbi të rinjtë që shërbejnë si modele e kanë përdorur zërin e tyre për të ndikuar në çështjet e rëndësishme. Materiali është punuar nga Fredens Hus (Shtëpia e Paqes e përmendur më sipër). Materiali gjendet në internet dhe mund të përdoret drejtpërdrejt nga mësuesit. Ai u hartua në vitin 2021 si kalendar për vitin e ri, por mund të përdoret sigurisht në mënyra të tjera. Një pyetje kryesore është si mund të ndikojnë fëmijët në botë. Filmat synojnë t’i frymëzojnë fëmijët të reflektojnë vetë mbi ato çështje që i mendojnë të rëndësishme. Çfarë padrejtësish ndodhin përreth tyre në jetën e përditshme? Po në botë? Si mund të përfshihen dhe të ndikojnë për një botë më të mirë? Për secilin film jepen sugjerime për ushtrimet që mësuesit mund të zhvillojnë në klasë, pasi të jetë parë filmi.

Fredens Hus (Shtëpia e Paqes) në Uppsala është një organizatë që punon përmes ekspozitave, projekteve dhe aktiviteteve edukative, që përqendrohen te fëmijët dhe të rinjtë. Përveç shembullit të “Heronjve të Demokracisë” më sipër, Fredens Hus ofron seminare dhe ushtrime në vend ose digjitale për klasat e shkollës lidhur me menaxhimin e konfliktit, barazinë gjinore, qytetarinë aktive dhe racizmin/mostolerancën. Ata takohen me rreth 500-700 klasa shkollore dhe grupe të rinjsh çdo vit. Shembujt e paketave dhe seminareve për shkollat dhe të rinjtë përfshijnë:

- **Demokracia** – një seminar që iu drejtohet nxënësve të vitit 4-6, i cili përqendrohet te demokracia dhe te mënyra sesi nxënësit mund të ndikojnë në shoqërinë që jetojnë. Një seminar në klasë, me mbështetje fizike ose digjitale nga një prej pedagogëve të Fredens Hus. Ushtrime krijuese, të kombinuara me diskutime dhe reflektim mbi të drejtat e njeriut dhe rolin e demokracisë.
- **Një javë lufte për liri** – një lojë edukative në një sallë të veçantë, ku studentët marrin rolin e luftëtarëve të të drejtave civile. Përmes gjëegjëzave, sfidave dhe lojës, loja ka të bëjë me ndalimin e një grushti ushtarak në një

vend me demokraci të brishtë duke përdorur mjete paqësore. Brenda një kohe të caktuar dhe me intensitet të lartë, klasa duhet të zgjidhë detyrat përmes bashkëpunimit në grup, të gjejë gjëgjëzat dhe përgjigjet e tyre dhe për të ecur përpara. Gjatë lojës, ata marrin pjesë në citime, histori dhe informacione nga ngjarje reale që kanë lidhje me temën.

Flamman socialt förebyggande centrum (Qendra Flaka për Parandalim Social) në Malmö, është qendër argëtuese për të rinjtë e grupmoshës 13-20 vjeçe dhe një vend me një ekip të përkushtuar, i cili punon për zhvillimin social të të rinjve. Qendra përqendrohet te promovimi i zhvillimit pozitiv të shoqërisë përmes projekteve sociale. Shumë prej nismave lidhen me përhapjen e vlerave dhe praktikave demokratike. Qendra angazhohet në programet kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit, programet e largimit nga bandat dhe jeta e krimit, programet e mentorimit, si dhe projektet për barazinë dhe fuqizimin. Një shembull konkret i viteve të fundit është fuqizimi i vajzave:

- **Hapësirë e sigurt** – një projekt që ka të bëjë me krijimin e “hapësirave të sigurta” për vajzat që të mblidhen e të diskutojnë. Qendra ka organizuar seminare të veçanta për vajzat/gratë (grupmosha 13-25 vjeçe) për të folur rreth demokracisë dhe fuqizimit, por edhe takime të përmuajshme për vajzat/gratë e reja (grupmosha 15-21 vjeçe), për të nxitur krijimin e lidhjeve përmes bisedave rreth të rinjve që janë model, rreth mënyrës sesi gratë e reja mund të angazhohen dhe ta mbështetin njëra-tjetrën dhe të kenë kurajën dhe energjinë për të ndikuar në shoqëri.

5. BURIME DHE REFERENCA

Raporti mbështetet kryesisht mbi informacione, raporte, artikuj, materiale burimore, *podkaste* etj., që mund të gjenden në internet, në faqet e autoriteteve qeveritare suedeze dhe enteve të tjera përgjegjëse për sistemin arsimor suedez dhe/ose që kanë lidhje me edukimin demokratik në sistemin arsimor. Ato renditen më poshtë, së bashku me referencat e faqeve të internetit. Informacionet rreth praktikave apo shembujve janë marrë edhe përmes faqeve të internetit të bashkive ose shkollave, si dhe gazetave lokale në internet. Gjatë procesit të planifikimit, ekipi zhvilloi edhe intervista të shkurtra me informatorët kyç në Agjencinë suedeze të Rinisë dhe Shoqërisë Civile, Agjencinë Kombëtare suedeze të Arsimit, Inspektoratin suedez të Shkollave, Institutin Kërkimor suedez të Arsimit, Shoqatën suedeze të Autoriteteve Vendore dhe Rajoneve dhe disa mësues që punonin në nivele të ndryshme.

- Agjencia suedeze e Rinisë dhe Shoqërisë Civile (Myndigheten för Ungdoms- och Civilsamhällesfrågor/ MUCF) <https://www.mucf.se/>
- Akti suedez për Arsimin (2010:800) https://www.riksdagen.se/sv/dokument-lagar/dokument/svensk-forfattningssamling/skollag-2010800_sfs-2010-800#K4
- Agjencia Kombëtare suedeze e Arsimit (Skolverket) <https://www.skolverket.se/>
- Council of Europe (2018) The Council Of Europe Reference Framework Of Competences For Democratic Culture: Learning And Practicing Democracy Through Education, Retrieved: <https://www.coe.int/en/web/education/competences-for-democratic-culture>
- Cooper, A (2019) School as a Democracy Project : A Poststructural Discourse-Theoretical Analysis of Schools' Democratic Mission and Teacher Subjects, Dissertation Thesis, Karlstad University.
- Council of Europe (2010) Council of Europe Charter on Education for Democratic Citizenship and Human Rights Education, Adopted in the framework of Recommendation CM/Rec(2010)7 of the Committee of Ministers, Retrieved: <https://www.coe.int/en/web/compass/council-of-europe-charter-on-education-for-democratic-citizenship-and-human-rights-education>
- Flamman <https://flammanmalmo.se/>
- Fredens Hus <https://www.fredenshus.se/>
- Fridays For Future <https://fridaysforfuture.se/>
- Instituti suedez (2021), Sistemi shkollor suedez <https://sæden.se/life/society/the-sæedish-school-system>
- Instituti Kërkimor suedez i Arsimit (Skolforskningsinstitutet) <https://www.skolfi.se/>
- Inspektorati suedez i Shkollave (Skolinspektionen) <https://www.skolinspektionen.se/>
- K12 Academics, History of Education in Sweden <https://www.k12academics.com>
- OECD (2015), Education Policy Outlook: Sweden, available at: www.oecd.org/education/policyoutlook.htm
- Sindikata suedeze e Mësuesve (Lärarförbundet) <https://www.lararforbundet.se/>

- Shoqata suedeze e Autoriteteve Vendore dhe Rajoneve /ShSAVR (Sveriges Kommuner och Regioner/SKR) <https://skr.se/skr.25.html>
- The Norden Association (Föreningen Norden) <https://norden.se/in-english/>
- Parlamenti i Suedisë (Riksdagen) <https://www.riksdagen.se/sv/>
- V-Dem Institute (2022), DEMOCRACY REPORT 2022, Autocratization Changing Nature? Marrë: https://v-dem.net/media/publications/dr_2022.pdf
- Johan Olsson, Zëvendës drejtor me fokus të veçantë tek shëndeti i nxënësve, shkolla Neptuni, bashkia e Malmös.

SHTOJCAT

Shtojca 1 – Modeli suedez i administratës qeverisëse

Suedia ka tri nivele qeverisjeje: kombëtare, rajonale dhe vendore. Zgjedhjet për përfaqësuesit e asambleve mbahen në të tria nivelet çdo katër vjet, në të njëjtën ditë në muajin shtator.

Niveli kombëtar: Në nivel kombëtar, qytetarët suedezë përfaqësohen nga Riksdag-u (parlamenti suedez), që ka kompetenca ligjvënëse. Propozimet për ligjet e reja paraqiten nga qeveria, e cila po ashtu zbaton vendimet e marra nga Riksdag-u. Në punën e saj, qeveria ndihmohet nga Zyrat Qeveritare, që përfshijnë një sërë ministrish dhe rreth 400 agjenci qendrore qeveritare dhe administrata publike. Agjencitë qeveritare janë instrumentet më të rëndësishme që ka qeveria për zbatimin e politikave të saj.

Niveli rajonal: Suedia është e ndarë në 21 rajone. Detyrat politike në nivel rajoni kryhen, nga njëra anë, nga këshillat rajonale, vendimmarrësit e të cilëve zgjidhen drejtpërdrejt nga qytetarët e rajonit dhe, nga ana tjetër, nga bordet administrative të rajonit, që kanë organet qeverisëse të rajonit. Disa autoritete publike veprojnë si në nivel rajonal, ashtu edhe lokal, për shembull, përmes bordeve të rajonit.

Niveli lokal: Suedia ka 290 bashki. Çdo bashki ka një asamble të zgjedhur, këshillin bashkiak, i cili merr vendime për çështjet bashkiake. Këshilli bashkiak emëron bordin ekzekutiv bashkiak, i cili drejton dhe bashkërendon punën e bashkisë.

Krahasuar me shumë vende të tjera, bashkitë dhe rajonet suedeze kanë përgjegjësi mjaft të gjera. Nuk ka marrëdhënie hierarkike midis bashkive dhe rajoneve, duke qenë se kanë autoritetet e tyre vetëqeverisëse dhe përgjegjësi për shërbime të ndryshme.

Shërbimet e ofruara në nivel lokal dhe rajonal financohen kryesisht nga taksat dhe tarifat e këshillave lokale dhe rajonale. Taksat vendosen si përqindje mbi të ardhurat e banorëve. Bashkitë dhe rajonet vendosin vetë për normat e tyre tatimore (norma mesatare e taksave vendore është 30 për qind).

Shtojca 2 – Autoritetet dhe organizatat

Autoritetet qeveritare

Ministria e Arsimit dhe Kërkimit Shkencor – përgjegjëse për politikën qeverisëse në arsim dhe kërkimin shkencor. Ministria punon gjithashtu për çështjet që përfshijnë performancën e shkollave, kushtet e mësuesve dhe financimin e studimeve.

<https://www.government.se/government-of-sæeden/ministry-of-education-and-research/>

Agjencia Kombëtare suedeze e Arsimit (Skolverket) është autoriteti kryesor administrativ arsimor, përgjegjës për t'iu garantuar të gjithë nxënësve dhe studentëve të njëjtin standard arsimor me cilësi të lartë. Agjencia përgatit rregullat dhe rekomandimet, përfshi kurrikulat, planet mësimore, provimet kombëtare dhe kriteret e vlerësimit me notë. Përveç kësaj, agjencia mbështet punën zhvillimore, ofron informacione dhe materiale mbështetëse dhe është përgjegjëse për certifikimin kombëtar të mësuesve dhe mësuesve të parashkollorit, administrimin e granteve të caktuara qeveritare, studimet dhe statistikat zyrtare të arsimit dhe pjesëmarrjen e Suedisë në studime ndërkombëtare.

<https://www.skolverket.se/andra-sprak-other-languages/english-engelska>

Inspektorati suedez i Shkollave (Skolinspektionen) është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe sigurimin e cilësisë në shkolla me anë të inspektimeve të rregullta dhe vlerësimit të kërkesave për ngritjen e shkollave të pavarura. Objekt i veprimtarisë së saj janë parashkollori (kryesisht, parashkollori në bashki), shkollat e arsimit të detyrueshëm, arsimit të mesëm të lartë dhe forma të ndryshme të arsimit për të rritur. Inspektorati monitoron përputhshmërinë me legjislacionin dhe rregulloret, duke përfshirë Ligjin për Arsimin. Qëllimi kryesor i tij është të kontribuojë për përmirësimin dhe zhvillimin e shkollës.

Inspektorati suedez i Shkollave përfshin edhe **Përfaqësuesin e Fëmijës dhe Studentit (Barn- och elevombudet/BEO)**, i cili mbron të drejtat e fëmijëve dhe studentëve dhe heton raportet për bullizëm dhe sjellje abuzive në shkolla, si dhe mund të kërkojë dëmshpërblim për llogari të fëmijëve dhe studentëve që kanë qenë objekt i sjelljes abuzive dhe bullizmit.

<https://www.skolinspektionen.se/other-languages/english-engelska/>

Instituti Kërkimor suedez i Arsimit (Skolforskningsinstitutet) është një agjenci qeveritare përgjegjëse për të kontribuar në zhvillimin dhe të nxënësve të fëmijëve dhe nxënësve përmes prodhimit të përmbledhjeve kërkimore shkencore dhe financimit të kërkimit shkencor mbështetur në praktikë për mësimdhënien dhe mësimnxënien në institucionet parashkollore dhe në shkolla. Instituti ka hartuar një përmbledhje kërkimore-shkencore mbi “Mendimin kritik dhe kritikën e burimeve – edukimi qytetar” dhe po përgatit një studim vlerësues sistematik rreth mësimdhënies mbi demokracinë, që do të botohet në fund të vitit 2022.

<https://www.skolfi.se/other-languages/english/>

<https://www.skolfi.se/other-languages/english/research-summaries/critical-thinking-and-source-criticism-social-studies-instruction/>

<https://www.skolfi.se/other-languages/english/research-summaries/systematic-review-about-teaching-democracy/>

Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Shkollave me Nevoja të Veçanta (Specialpedagogiska skolmyndigheten) është përgjegjëse për të garantuar që fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit të kenë kushte të përshtatshme për përmbushjen e objektivave të tyre arsimore, pavarësisht aftësisë funksionale. Ky objektiv zbatohet përmes mbështetjes për nevoja të veçanta, shkollave për nevoja të veçanta, materiale mësimore të aksesueshme dhe financimit qeveritar.

<https://www.spsm.se/om-oss/other-languages/english/>

Bordi i Shkollave Sami (*Sameskolstyrelsen*) është agjenci administrative për shkollat publike Sami dhe aktivitetet e lidhura me to, që rregullohen nga Dekreti për Shkollat Sami.

<https://sameskolstyrelsen.se/myndigheten/>

Agjencia suedeze e Rinisë dhe Shoqërisë Civile (*Myndigheten för ungdoms- och civilsamhällesfrågor*) ka si detyrë përhapjen e informacionit mbi kushtet e jetesës për të rinjtë dhe kushtet për shoqërinë civile. Agjencia është përgjegjëse për të siguruar që agjencitë shtetërore të marrin në konsideratë këndvështrimin e të rinjve, duke ofruar mbështetje për bashkitë në politikat e tyre të rinisë dhe duke shpërndarë grante për organizata të vogla e të mëdha. Gjatë viteve zgjedhore, agjencia ngarkohet nga qeveria të mbështetë organizimin e zgjedhjeve në shkolla dhe ka hartuar materiale metodologjike për ligjërimin demokratik në shkolla. Agjencia është angazhuar gjithashtu për krijimin e modeleve sesi bashkitë mund të nxitin njohuritë e të rinjve rreth demokracisë vendore.

<https://skolval.mucf.se/en>

Forumi "Historia Jeton" (*Forum för Levande Historia*) është një agjenci publike që vepron në varësi të Ministrisë së Kulturës dhe ka për detyrë promovimin e demokracisë, tolerancës dhe të drejtave të njeriut, duke përdorur si pikënisje njohuritë dhe mësimet nga Holokausti ose krime të tjera kundër njerëzimit. Agjencia ka misionin konkret për rritjen e ndërgjegjësimit mbi Holokaustin dhe krime të tjera përmes ekspozitave, kurseve, raporteve, anketave dhe seminareve. Sa i takon edukimit të rinisë, agjencia ka hartuar materiale pedagogjike për mësues dhe studentë mbi demokracinë, tolerancën dhe të drejtat e njeriut, si dhe materiale për përdorim në klasë rreth bashkëbisedimeve demokratike, kritikës së burimeve, propagandës, të drejtave dhe barazisë.

<https://www.levandehistoria.se/english>

Organizata anëtare

Shoqata suedeze e Autoriteteve Vendore dhe Rajoneve – ShSAVR-ja (*Sveriges Kommuner och Regioner, SKR*) është organizatë e punëdhënësve dhe që përfaqëson dhe përkrah pushtetin vendor në Suedi. Të 290 bashkitë dhe 21 rajonet janë anëtare të ShSAVR-së. Shoqata reket të nxitë e të forcojë zhvillimin e demokracisë rajonale dhe vendore. ShSAVR-ja është angazhuar për promovimin e buxhetimit me pjesëmarrje dhe rritjen e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrjen lokale. Që nga viti 1989, Shoqata organizon "Parlamentin Shkollor", një konferencë e përdyvjeshme dhe hapësirë takimi për përfaqësuesit e zgjedhur vendorë dhe zyrtarët e angazhuar në arsim, duke përfshirë drejtorët e shkollave.

<https://skr.se/skr/englishpages.411.html>

Shoqata suedeze e Shkollave të Pavarura (*Friskolornas Riksförbund*) është bashkim i institucioneve të pavarura parashkollore dhe shkollore. Të gjithë ata që drejtojnë ose mendojnë të drejtojnë një institucion parashkollor apo shkollë mund të bëhen anëtarë të Shoqatës suedeze të Shkollave të Pavarura. Objektivi i shoqatës është të zhvillojë dhe të rritë cilësinë e institucioneve parashkollore dhe shkollave në Suedi, mbështetur në shtyllat e zgjedhjes për fëmijët, nxënësit dhe prindërit, kushtet e barabarta për gjithkënd të përfshirë dhe përqendrimin te cilësia.

Shoqata suedeze e Drejtorëve të Shkollave dhe Drejtorëve të Arsimit (*Sveriges skolledarförbund*) është një sindikatë e drejtuesve në shkolla dhe sektorin arsimor, përfshi drejtorët dhe nëndrejtorët e shkollave. Shoqata iu ofron anëtarëve shërbimet e sindikatës dhe ka për qëllim të jetë pjesëmarrëse kryesore në debatet kombëtare mbi shkollat dhe politikën arsimore.

<https://www.friskola.se/in-english/>

Sindikata suedeze e Mësuesve (*Lärarförbundet*) është sindikata më e madhe për mësuesit, drejtorët e shkollave, mësuesit e studentëve dhe këshilltarët e studimeve dhe të karrierës, e cila përqendrohet te mbrojtja dhe përmirësimi i të drejtave të anëtarëve të saj në fusha si paga, orari i punës, mjedisi i punës dhe zhvillimi profesional përmes dialogut, negociatave dhe advokimit. Përveç kësaj, sindikata ofron mbështetje lidhur me kurset, seminarët, manualët dhe seminarët në internet rreth temave të ndryshme, përfshi ato që lidhen me kurrikulën/lëndët.

<https://www.skolledarna.se/sallansidor/In-English/>

Shoqatat/federatat e studentëve dhe prindërve (adresat e faqeve të internetit në suedisht)

Shoqata suedeze e Këshillave të Nxënësve (*Sveriges Elevråd*) – shoqatë kombëtare për organizatat e nxënësve në arsimin e detyrueshëm, që mbështet veprimtaritë e këshillave të nxënësve. Anëtarët kanë qasje në materialet mbështetëse, trajnime, udhëzues dhe formate tip për mbledhjet dhe aktivitetet e tyre. Është krijuar në vitin 2010 (>10000 anëtarë) <https://sverigeselevrad.se/>

Federata suedeze e Organizatave Studentore (*Sveriges Elevkårer*), e themeluar në vitet '50, është organizata më e madhe rinore me rreth 130 000 anëtarë nga shkollat e mesme të larta nga e gjithë Suedia. Ajo përqendrohet te krijimi i mundësisë për studentët që të krijojnë shoqata – organizata studentore – në shkollat e tyre dhe të mbështetin punën e tyre, për ta bërë shkollën më të sigurt, më të fortë dhe më argëtuese. Vizioni i tyre është që çdo shkollë e mesme të ketë një organizatë studentore të suksesshme, e cila, ndërsa kujdeset për interesat studentore akademike, financiare, ligjore dhe sociale, punon për të promovuar një kohë më shpërblyese në shkollë për anëtarët e vet.

<https://sverigeselevkarer.se/>

Federata suedeze e Nxënësve dhe Studentëve (*Elevernas Riksförbund*), e themeluar në vitin 1994, organizohet nga dhe për studentët (arsimi i mesëm i lartë) dhe nxënësit (viti 6-9), me qëllim promovimin e një shkolle më të mirë e më demokratike. Federata është e angazhuar të punojë me të gjitha shkollat në mbarë Suedinë, për të zhvilluar dhe forcuar praktikën demokratike dhe, aktualisht, po punon për një projekt të quajtur “Forumi demokratik”.

<https://elevernasriksforbund.se/>

Aleanca suedeze e Prindërve (*Föräldraalliansen Sverige*) është organizatë kombëtare e bazuar në interesa për prindërit dhe shoqatat e prindërve dhe përqendrohet te zhvillimet në shoqëri që nxitin mirëqenien, zhvillimin, të nxënësve dhe shëndetin e çdo fëmije. Aleanca shpërndan informacione, monitoron çështjet e politikës arsimore (iu përgjigjet referimeve, nxjerr letra për botuesit dhe deklarata për shtyp), punon për rolin dhe ndikimin e prindërve, rritjen e bashkëpunimit midis prindërve, shkollës dhe institucioneve të tjera sociale dhe iu jep mbështetje shoqatave të prindërve, si dhe bashkëpunon me organizata dhe autoritete të tjera. <https://www.foralldraalliansen.nu/>

Shtojca 3 – Financimi, buxhetimi, menaxhimi financiar dhe pjesëmarrja

Buxhetimi dhe menaxhimi financiar në nivel bashkie

Autoritetet vendore janë të detyruara me ligj të ofrojnë shumë shërbime bazë si arsimit fillor, i mesëm dhe kujdesi për fëmijët (përmes çerdheve dhe kopshteve), që përbëjnë një pjesë të rëndësishme. Një pjesë e madhe e fondeve për financimin e shkollave vjen nga **të ardhurat e taksave bashkiake**, të cilat shpërndahen pastaj sipas modeleve të ndryshme të financimit, në varësi të bashkisë. Përveç taksave, bashkitë marrin edhe grante të përgjithshme nga shteti, të cilat përlogariten përmes sistemit të transferimit të fondeve kompensuese për bashkitë. Gjithashtu bashkitë kanë të drejtë të marrin grante shtetërore me destinacione të ndryshme lidhur me arsimin, me qëllim kryesor promovimin e barazisë. Një objektiv i shpërndarjes së fondeve për shkollat sipas bashkive ishte që shpërndarja e fondeve të bëhej më mirë dhe t'u përshtatej nevojave dhe përparësive vendore. Bashkitë janë të lira të përdorin taksat e mbledhura dhe fondet shtetërore për shërbimet dhe sistemet që ato e shohin të arsyeshme. Megjithatë, financimi i shkollave nuk u lihet plotësisht në dorë bashkive, duke qenë se shpërndarja e përgjithshme e fondeve ndikohet nga e ashtuquajtura 'zgjedhja e lirë e shkollës' pas vendimit të parlamentit për të futur **sistemin e transferimit të pagesave kompensuese (grante për shkollën) të lidhura me nxënësit/studentët** dhe jo me shkollat. Transfertat e vlerësuara mendohet të mbulojnë jo vetëm arsimin, por edhe shpenzime të tjera, përfshirë ushqimin, shërbimet shëndetësore dhe ekskursionet. Ky sistem nënkupton që të jepet një sasi parash për çdo nxënës, duke ndjekur nxënësin në cilëndo shkollë që ai zgjedh të studiojë, qoftë bashkiake apo e pavarur. Si shkollat bashkiake edhe ato të pavarura financohen përmes sistemit të granteve për shkollat. Një shkollë e pavarur e cila merr një financim të tillë nga bashkia nuk ka të drejtë të kërkojë tarifa nga nxënësit për shkollën, por është e lirë të administrojë vetë organizimin e shkollës (sistemin e drekës në shkollë, pagat e mësuesve, mësuesit e veçantë, etj.) dhe lejohet të nxjerrë edhe një fitim, d.m.th., nuk është e detyruar ta ri-investojë fitimin në shkollë. Kjo gjë është debatuar në parlamentin suedez.

Midis bashkive dhe midis shkollave ka ndryshime në lidhje me nivelin e burimeve financiare. Kjo ndodh sepse madhësia e grantit për nxënës/student ndryshon nga bashkia në bashki, por gjithashtu madhësia mund të ndryshojë edhe midis shkollave brenda të njëjtës bashki, kryesisht midis shkollave në zonat e cenueshme socio-ekonomike dhe shkollave në zona të tjera. Është diskutuar nëse një gjë e tillë është në përputhje me parimin e barazisë, duke përfshirë edhe madhësinë e granteve që u jepen shkollave të pavarura.

Procesi i vendimmarrjes dhe financimit në nivel bashkiak përfshin hapat e mëposhtme:

1. Kuvendi i zgjedhur në nivel vendor vendos për buxhetin bashkiak i cili përfshin buxhetin e sistemit arsimor në bashki. Buxheti për arsimin mbështetet kryesisht në numrin e fëmijëve të shkollës dhe të nxënësve të regjistruar në bashki. Ai ndikohet edhe nga niveli i taksave bashkiake.
2. Bordi drejtues përgjegjës për arsimin në bashki vlerëson madhësinë e grantit bashkiak për shkollën e mbështetur në udhëzimet e Aktit për Arsimin. Çdo shkollë merr fonde bazuar në numrin e nxënësve/studentëve në shkollë, nevojave të veçanta pedagogjike dhe të cenueshmërisë socio-ekonomike.
3. Në dhjetor shkollat informohen për financimin e parashikuar për vitin e ardhshëm. Parashikimi mund të përshtatet disi gjatë vitit të ardhshëm. Kjo ndodh sepse zgjedhja e lirë e shkollës u jep nxënësve mundësinë për ta përshtatur kërkesën, që do të thotë se disa studentë mund të vendosin të studiojnë në një shkollë tjetër nga ajo ku janë pranuar për herë të parë. Kjo ndodh në veçanti në rastin e shkollës së mesme ku nxënësit pranohen në bazë të meritës, por mund të ndodhë edhe për nxënësit e shkollës fillore kur nxënësi/prindi vendos të ndërrojë shkollën. Buxheti për secilën shkollë përshtatet bazuar në ndryshimet e mundshme të numrit të nxënësve/studentëve.

4. Pavarësisht nëse është një shkollë në pronësi të bashkisë, apo një shkollë e pavarur, shkolla duhet t'i përmbahet:
 - a. Parimit të zgjedhjes së lirë të shkollës,
 - b. Sistemit të granteve për shkollën,
 - c. Të gjitha aspekteve të arsimit në shkollë që duhet të jenë pa pagesë.

Madhësia e grantit për shkollë dhe shkalla e financimit mbështeten në faktorët e mëposhtëm:

- **Numri i nxënësve/studentëve në shkollë** – Duke qenë se granti për shkollë jepet në bazë të çdo nxënësi/studenti, bashkitë i shpërndajnë fondet për shkolla bazuar në numrin e nxënësve.
- **Veçoritë socio-ekonomike të zonës** – Bashkitë duhet të kenë parasysh vendndodhjen e shkollës bazuar në indeksin socio-ekonomik. Indeksi përbëhet nga faktorë të tillë si cenueshmëria socio-ekonomike, niveli i arsimit në atë zonë, etj. Një shkollë me indeks mbi 100 zakonisht do të thotë se është një shkollë që ka nevojë për burime financiare shtesë, me qëllim që të ketë më shumë mësues dhe funksione të tjera mbështetëse, paga më të larta që t'i nxisin mësuesit të kërkojnë të punojnë në ato shkolla dhe që të stimulojë vijimësinë.
- **Shkalla e taksimit bashkiak** – Taksa bashkiake vendoset në nivel bashkie nga një bord i zgjedhur politikisht. Shpesh ndodh që taksat janë më të ulëta në bashki më të pasura dhe si rrjedhojë tendenca është që ato të marrin një grant më të ulët për shkollë.
- **Programi mësimor**, pra, ai i zakonshmi apo ai për nxënësit me nevoja të veçanta - bashkitë kanë nevojë t'u shpërndajnë burime shtesë shkollave me nxënës me nevoja të veçanta. Ka dy lloj shkollash për nxënës/studentë me nevoja të veçanta: Shkolla me nevoja të veçanta (shkolla ku nxënësit/studentët kanë nevoja të veçanta) dhe Shkollat e integruara me nevoja të veçanta (shkolla të zakonshme ku janë integruar nxënës/studentë me nevoja të veçanta të përfshirë në të njëjtat klasa si nxënësit/studentët e tjerë, por me burime shtesë, apo klasa të veçanta në shkollë – varet nga drejtori që të vendosë nëse klasat duhen integruar apo jo).
- **Kërkesat për grante shtetërore të financuara nga Agjencia e Arsimit** – bashkia mund të bëjë kërkesë për fonde për iniciativë të integruara, të tilla si një fokus më i madh për lëndë specifike si Matematika apo Suedishtja si gjuhë e dytë, apo aspekte të tilla si demokratizimi, barazia gjinore dhe LGBTQ+, një mjedis paqësor studimi, qeverisje të mirë dhe transparencë midis drejtuesve, mësuesve dhe nxënësve, etj. Bashkia zgjedh se cilat shkolla në veçanti kanë nevojë për fonde të tilla të synuara. Shkollat e veçanta po ashtu mund të tregojnë interes për disa iniciativë të caktuara dhe bashkia bën kërkesë për fonde shtetërore në emër të tyre.

Koncepti i 'zgjedhjes së lirë të shkollës', pra, që çdo nxënës në shkollë fillore duhet të ketë mundësi të shkojë në çdo shkollë brenda bashkisë (me kusht që të ketë vende të lira), do të thotë gjithashtu që aspektet financiare të tilla si transporti nuk duhet të përbëjnë pengesë. Rrjedhimisht, bashkia duhet t'u japë nxënësve dhe studentëve që jetojnë larg nga shkolla një abone për autobus. Në rastin e bashkisë së Malmös, në jug të Suedisë, periudha e aplikimit për abone është e hapur dy herë në vit dhe ata që banojnë më larg se 3.8 km nga shkolla kanë të drejtë të përfitojnë. Bashki të tjera, ndonjëherë në bashkëpunim me Administratën Rajonale, u ofrojnë një abone të tillë pa para për autobus të gjithë nxënësve dhe nxënësve të rajonit (si në rajonin Jämtland Härjedalen në Suedinë Veriore).

Buxhetimi dhe administrimi financiar në nivel shkolle

Si rregull, përgjegjësia dhe administrimi i fondeve janë të decentralizuara në nivel shkolle, ku drejtorët kanë rolin kryesor. Megjithatë, mënyra e administrimit të fondeve në praktikë mund të ndryshojë, në varësi të faktit nëse organizatori është një bashki e madhe apo e vogël, dhe nëse shkolla drejtohet nga një organizator i pavarur, i cili mund të jetë në formën e një kompanie të madhe apo të vogël, fondacioni apo shoqate ekonomike.

Shkollat në pronësi të bashkisë (pra, shumica e të gjitha shkollave të Suedisë) nuk kanë llogari të tyre bankare. Por çdo shkollë bashkiake ka postin e vet të buxhetit (budget post) me nënposte buxhetore brenda buxhetit bashkiak. Megjithëse procesi i rekrutimit të mësuesve në shkolla është përgjegjësi e drejtorit, mësuesi nuk punësohet nga shkolla, por nga administrata e shkollave fillore të bashkisë. Kur drejtori përgatit buxhetin e shkollës, ai duhet të marrë parasysh shpenzimet e pritshme të shkollës. Pothuaj gjysma e buxhetit të shkollës përdoret për pagat, ndërsa pjesa tjetër përdoret për libra dhe për pajisje të tjera shkolle si laptopë, dreka, rinovime, për programin shëndetësor të shkollës, piknikë e ekskursione.

Sikundër është përmendur në kapituj të mëparshëm, shkolla suedeze ka detyra të mëdha përveç promovimit të njohurive dhe aftësive. Shkolla duhet gjithashtu të promovojë vlerat dhe të rrisë qytetarë demokratë dhe gjithashtu, duhet të përforcojë një stil të shëndetshëm jete. Këtë mund ta quani “Trekëndëshi i të mësuarit” që përfshin pedagogjinë, vlerat sociale dhe shëndetin (mendor dhe fizik) si vlera bazë të rëndësishme. Ky trekëndësh duhet pasur parasysh gjithashtu edhe në **buxhetimin dhe administrimin financiar të shkollës.**

Për faktin që **të gjitha aktivitetet e shkollës duhet të jenë pa pagesë**, shkolla duhet të mbulojë koston e drekës dhe të ushqimit gjatë ekskursioneve dhe piknikëve, duke qenë se nuk lejohet që t’u kërkohet prindërve/kujdestarëve t’u japin fëmijëve ushqim për drekë apo midis vakteve – të gjitha këto duhen mbuluar nga shkolla. Një shembull tjetër i shkollës pa pagesë është se shkollës i duhen fonde edhe për kremtimet e fundit të vitit shkollor të shkollës së mesme, përfshirë ballon e diplomimit të shkollës së mesme, sepse nuk mund të pritet që prindërit/kujdestarët/ studentët t’i përballojnë vetë këto shpenzime. Për shkak të arsimit pa pagesë, një iniciativë e tillë si një udhëtim me shkollën nuk mund të paguhet me kontribute të prindërve, përveçse kur bëhet një dhurim për gjithë klasën. Prandaj shpesh janë vetë studentët që shesin ëmbëlsira, bileta lotarie, çorape, etj., për gjithë klasën dhe jo për të dhënë kontribute individuale.

Një shembull nga shkolla e ciklit të ulët të shkollës së mesme Neptuni (klasat 7-9) në Malmö, e ilustron më së miri se si **një vendim i vetëdijshëm i përfshirjes dhe qëndrueshmërisë mund të shqyrtohet edhe kur bëhet fjalë për një buxhet shumë të vogël:** në fillim të vitit shkollor, e gjithë klasa e kaloi javën e parë duke bërë ekskursione të ndryshme. Meqenëse shkolla ishte përgjegjëse për drekën dhe pijet që fëmijët merrnin me vete, shkolla vendosi të investonte për një shishe uji të ri-përdorshme për të gjithë studentët. Kjo do të pakësonte mbetjet plastike, duke qenë se studentët mund t’i rimbushin shishet. Në këtë mënyrë nxitet shëndeti, meqë uji është më i shëndetshëm se lëngu i frutave apo pijet me gaz. Shishet e ujit promovuan gjithashtu identitet të njëjtë, sepse të gjitha shishet kishin të njëjtën pamje dhe mbi to ishte vënë emblema e bashkisë së Malmos. Edhe ngjyra e shishes ishte zgjedhur qëllimisht - e kuqe dhe blu e fortë, për t’iu kundërvënë normave gjinore.

Për sa i takon pyetjes nëse **shkollat suedeze bashkëpunojnë apo jo me organizatat e shoqërisë civile dhe nëse buxhetet e shkollave mund të përdoren për bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile dhe e kundërta**, kjo është diçka që nuk ndodh zakonisht, dhe po ndodh gjithnjë e më rrallë. Shkolla duhet të jetë jo-politike dhe jo-rrëfyese (në kuptimin fetar) dhe duhet të nxisë vlerat e përbashkëta themelore. Ndërsa dikur krahët politikë të të rinjve shkonin nëpër shkolla për të inkurajuar vetëdijen politike, kjo nuk ndodh më rëndom. Tani një ndërgjegjësim i tillë nxitet përmes autoriteteve publike. Dikur ndodhte shpesh që të ftoheshin përfaqësues të një organizate të shoqërisë civile që punonte kundër alkoolit, drogës dhe duhanit, por vlera e kësaj gjëje është vënë në diskutim, duke qenë se

nga përvoja është parë se ndonjëherë mesazhet kanë qenë të njëanshme dhe dënonin në mënyrë kategorike disa pikëpamje dhe vlera të caktuara. Rrjedhimisht, megjithëse veprimtari të tilla financohen nga organizatat e shoqërive civile dhe nuk kushtojnë asgjë apo nuk kërkojnë ndonjë fond nga shkolla, janë problematike nga pikëpamja e krijimit të vlerave.

Megjithatë, ka organizata të shoqërisë civile që plotësojnë detyrat e shkollave. Çdo shkollë duhet të ketë dhe të buxhetojë fonde për një plan kundër diskriminimit dhe një plan për shëndetin e nxënësve. Për këtë arsye, disa bashkëpunime dhe iniciativa me organizatat e shoqërisë civile janë plotësuese. Për shembull, shkollat janë ftuar të vizitojnë një ekspozitë në Malmö për Holokaustin, organizuar nga Komiteti Suedez kundër Antisemitizmit (SCAA) i cili punon për parandalimin e kundërshtimit të antisemitizmit dhe formave të tjera të racizmit përmes informimit dhe edukimit. Organizata të tilla si, Shoqata e Sporteve në Shkollë (Skolidrottsförbundet) mbështet shkollat me kurse dhe materiale dhe edukojnë nxënësit/studentët që administrojnë shoqatat në nivel shkollor për të nxitur sportet nëpër shkollë. Shoqata Suedeze e Nxënësve të Bashkuar (Sveriges förenade elevkår) ofron trajnime dhe stërvitje për anëtarët e këshillit të nxënësve.

Buxhetimi me pjesëmarrje

Në Suedi, **buxhetimi me pjesëmarrje** nuk është i rregulluar me ligj dhe nuk ka ndonjë traditë të fortë lidhur me angazhimin e qytetarëve në proceset rajonale apo lokale të buxhetimit në përputhje me metodologjinë e buxhetimit me pjesëmarrje. Nga ana tjetër, Shoqata Suedeze e Autoriteteve Vendore (SALAR) ka disa vite që është angazhuar në promovimin e procedurave të buxhetimit me pjesëmarrje dhe ka krijuar një model dhe ngritur një rrjet bashkësh për ta zhvilluar më tej praktikën e buxhetimit me pjesëmarrje. Sipas SALAR-it, rreth 25-30 projekte në fusha të ndryshme të përgjegjësisë bashkiake janë zbatuar gjatë disa viteve të fundit. Disa prej këtyre shembujve përfshijnë bashkitë që janë fokusuar në angazhimin e nxënësve dhe studentëve në procesin e shprehjes së ideve, përcaktimin e përparësive, dhe votimit në lidhje me investimet bashkiake në sheshe lojërash, zona argëtimi, veprimtari pas shkolle, etj. (Për më hollësi, shihni pjesën 4.3)

Në nivel shkollor, **fëmijët suedezë kanë mundësi të ndikojnë në veprimtaritë e shkollës, duke përfshirë edhe në investime**. Në të shumtën e herëve, një ndikim i tillë lidhet me investime të vogla në sporte dhe pajisje për këndet e lojërave, që mund të përdoren gjatë pushimeve të shkollës, apo në investime në veprimtari shkollore që zhvillohen sipas sugjerimeve të fëmijëve. Megjithatë, ka raste kur fëmijët mund të konsultohen dhe për investime më të mëdha, për shembull, për këndet e lojërave. Ky lloj ndikimi shpesh organizohet përmes një procesi konsultimesh që mbahet në kuadër të klasës dhe këshillave të shkollës dhe unioneve të nxënësve (shih kapitujt 3 dhe 4).

Drejtori vendos nëse këshilli i nxënësve të shkollës mund të marrë një buxhet konkret për të cilin është përgjegjës (për shembull, 10,000 SEK në vit). Këto fonde mund të përdoren për të blerë, për shembull, pajisje sportive si topa futboll, rrjeta basketbolli, etj. Këto fonde janë një mjet për të promovuar:

1. Edukimin me proceset demokratike ku idetë kanalizohen përmes përfaqësuesve të këshillit të klasës në këshillin e shkollës,
2. Edukimin me vendimmarrjen,
3. Rritjen e të kuptuarit se jo të gjitha kërkesat mund të realizohen.

Projekti "Forcimi i edukimit për qytetari demokratike në Shqipëri"
zbatohet nga Këshilli i Evropës (KiE) dhe financohet nga Agjencia
Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida).